

Rama: Akuakultura vlerë e shtuar e ekonomisë blu, rritet në 30 mijë tonë prodhimi i peshkut

Faqe 4

AZHBR: Asnjë shkresë përfituesve për kthimin e fondeve të programit IPARD II

Faqe 4

Përvoja e FED invest-it në Konferencën EFSE DF, si kampion në përfshirjen financiare të fermerëve dhe sipërmarrësve të vegjël në ...

Faqe 7

KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR
Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

FED invest
Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i dytë i muajit shtator 2023 | Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 470 | Çmimi 125 lekë | E përdyjavshme e pavarur

FONDET IPARD TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË

PASOJAT NEGATIVE QË PO SHKAKTON NGRIRJA E FONDEVE IPARD TË BE-SË PËR SHQIPËRINË, JANË TË PAPËRBALLUESHME DHE TË PARIPARUESHME PËR SUBJEKTET PRIVATE QË OPEROJNË NË FUSHËN E EKONOMISË SË USHQIMIT

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar parashtron fakte mbi rëndësinë e programit IPARD në zhvillimin e bujqësisë. Sektori privat ka treguar se është tejet i interesuar për këtë program

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

RisiAlbania aktivitete për Rrjetëzimin e Shërbimeve të Karrierës në 5 universitete

Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri

RisiAlbania Partner for Growth

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2

GRATË NË SIPËRMARRJE

Në Labinot-Mal, 40 gra arrijnë të kultivojnë për herë të parë produkte dimërore

Faqe 7

REPORTAZH

Vila "ANASTASIA" në Krane, prapatoka turistike e Sarandës

Nga Shkëlqim Hajno

Faqe 10

KËNDI I EKSPERTIT

- *Skema kombëtare 2023, AZHBR: 7624 blegtorë janë financuar deri tani* Fq.4
- *Portofoli zviceran për arsimin profesional nis fazë të re deri në 2027-ën* Fq.6
- *500 aplikues më shumë se vitin e kaluar në degët e Universitetit Bujqësor* Fq.2
- *Kalendari bujqësor, muaji tetor 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari* Fq.13

Denaj me komisionerin e BE-së në Bruksel: Përafrim të plotë me politikën e përbashkët bujqësore evropiane

Faqe 2

BUJQËSI

Plantacion i vetëm i shegëve izraelite në Myzeqe jep prodhimin e parë

Faqe 5

RISI ALBANIA

RisiAlbania aktivitete për Rrjetëzimin e Shërbimeve të Karrierës në 5 universitete

RisiAlbania po kontribuon intensivisht në orientimin e të rinjve për integrimin e tyre në tregun e punës, përmes shërbimit të ndërmjetësimit dhe këshillimit të karrierës.

Falë kësaj pune të rëndësishme, sot shumë të rinj po orientohen drejt arsimit profesional si alternativa më e mirë që u shërben atyre për një punësim më efiçent dhe dobiprurës.

Të rejat dhe të rinjtë në Shqipëri përballen me vështirësi për t'u orientuar dhe integruar në tregun e punës. Kanë mungesë informacioni dhe hasin vështirësi për të bërë zgjedhjet e duhura dhe të mirëinformuara për karrierën. Për të plotësuar nevojat e tyre për punësim, RisiAlbania punon për të gjetur mënyrat dhe mekanizmat e duhur për të lidhur punëkërkuesit me tregun e punës, sipas aftësive, nevojave dhe interesave që ata kanë.

Në themel të këtyre ndërhyrjeve është përputhja e kërkesës me ofertën që ka sot tregu për punë. Kjo i mundëson punëkërkuesve dhe punëdhënësve të përshtaten me ndryshimet e tregut dhe të planifikojnë nevojat për aftësitë në të ardhmen. Ndërhyrjet tona orientohen drejt shërbimeve të ndërmjetësimit dhe këshillimit të karrierës.

Në kuadër të kësaj nisme RisiAlbania nisi në mesin e muajin shator 2023, një aktivitet rrjeti dy-ditor të fokusuar në Shërbimet e Karrierës në universitete, duke përfshirë Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakultetin e Shkencave Sociale Universiteti i Tiranës dhe Zyra e Karrierës e Bashkisë së Tiranës. Qëllimi është të stimulohet shkëmbimi

i njohurive midis këshilltarëve të karrierës dhe të ndërtohet një rrjet bashkëpunues. Diskutimet u përqendruan në këto tema kryesore:

Në fokus të punës është eksplorimi i praktikave më të mira se si universitetet mbështesin studentët, të diplomuarit dhe bizneset përmes shërbimeve të tyre të karrierës, duke ndezur kreativitetin dhe njohuritë përmes aktiviteteve në grup.

Gjithashtu pikë tjetër e rëndësishme është edhe diskutimi i strategjive për identifikimin e nevojave të studentëve dhe bizneseve, duke u nxjerrë nga përvoja e Shërbimeve të Karrierës të IAL-ve, si dhe përmbledhje e qasjeve efektive për të rritur dukshmërinë e zyrave të karrierës.

Duke folur për metrikat përkatëse dhe përcaktimin e qëllimeve të përmirësimit, duke përdorur studime të rasteve të botës reale si shembuj.

Eksplorimi i mënyrave inovative për të përfshirë teknologjinë në praktikat e këshillimit dhe strategjitë e marketingut, duke gjeneruar ide emocionuese të drejtuara nga teknologjia përmes ideimit të grupit bashkëpunues.

Në fund të ditës së parë, RisiAlbania është e emocionuar për diskutimet dhe bashkëpunimet e thella mes këshilltarëve të karrierës për të rritur shërbimet e karrierës në universitete.

BE - BUJQËSI

Denaj me komisionerin e BE-së në Bruksel: Përafrim të plotë me politikën e përbashkët bujqësore evropiane

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u shpreh se në takimin që zhvilloi në Bruksel, me komisionerin e Bashkimit Evropian, Janusz Wojciechowski, u vlerësua ecuria pozitive në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale për përafrimin me kuadrin rregullator sipas standardeve të BE-së.

"Zhvillova takimin tim të parë zyrtar si ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me komisionerin Janusz Wojciechowski, ku i shpreha mirënjohjen ndaj Komisionit Evropian për mbështetjen e vazhdueshme të dhënë për Shqipërinë në rrugën drejt integrimit në Bashkimin Evropian", tha Denaj.

Ministrja Denaj shprehu falënderim të thellë për punën e vyer të komisionit në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale për përafrimin me "acquis communitaire" (kuadrin rregullator dhe standartet e BE-së) në mbështetje të zhvillimit rural, sigurisë ushqimore dhe peshkimit, sektorë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe përafrim të plotë me politikën e përbashkët bujqësore evropiane përmes



fondeve IPA dhe IPARD.

Zbatimi i politikave të integrimit evropian dhe programeve të zhvillimit bujqësor e rural ka sjellë një tjetër hov zhvillimi në bujqësinë shqiptare për arritjen e standardeve evropiane në mbështetje të fermerëve, agropërpunimit, përmirësimin e konkurrencës, ndërsa vijon mbështetja e investimeve në zonat rurale për diversifikimin e ekonomisë rurale, duke çuar në zgjerimin e punësimit dhe përfshirjes sociale.

Denaj i shprehu komisionerit angazhimin maksimal për të vijuar bashkëpunimin me të gjithë strukturat përgjegjëse për garantimin e një procesi të suksesshëm dhe marrjen e masave për përmirësimet e nevojshme, si një garanci për integrimin e Shqipërisë.

Denaj në Bruksel: Objektiv, standardet europiane në mbështetje të fermerëve dhe agropërpunimit

Shqipëria është në bashkëpunim të plotë me Bashkimin Europian në hartimin e politikave publike në shërbim të zhvillimit rural.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj gjatë vizitës zyrtare në Bruksel, me strukturat e Komisionit Evropian, zhvilloi një takim edhe me drejtuesit e DG AGRI (Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural) në Komisionin Europian, ku shprehu objektivin ambicioz të qeverisë për zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme, sipas standardeve europiane.

"Gjatë vizitës në Bruksel me strukturat e Komisionit Evropian, me zv.ministrat Adela Xhemali dhe Enio Civici, zhvilluam një takim me drejtuesit e DG AGRI, dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, ku diskutuam politikat publike në shërbim të zhvillimit rural", tha ministrja Denaj.

Ministrja theksoi se fokus është zbatimi i politikave të integrimit europian dhe programeve të zhvillimit bujqësor dhe rural, me qëllim arritjen e objektivave strategjikë kombëtarë për arritjen e standardeve europiane në mbështetje të fermerëve dhe ndërmarrjeve agropërpunuese.

Denaj vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer që kemi me të gjitha strukturat e BE, teksa theksoi se, "Shqipëria po ndjek dhe përfiton nga eksperienca e vendeve që kanë kaluar procesin e anëtarësimit përpara vendin tonë".

"Mbetemi të angazhuar në përmbushjen e të gjitha kritereve në procesin e negociatave, ku partnerët kanë një rol të rëndësishëm", deklaroi ministrja Denaj.

500 aplikues më shumë se vitin e kaluar në degët e Universitetit Bujqësor

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) këtë vit ka arritur të marrë më shumë studentë, në përmbyllje të raundit të parë të aplikimeve dhe regjistrimeve në arsimin e lartë.

Fatbardh Sallaku, rektor i UBT-së, tha se, "numri i aplikantëve në Universitetin Bujqësor ka qenë rreth 500 aplikues më shumë se viti i kaluar, dhe përkthyer kjo në regjistrime aktualisht në raundin e parë, në programet e ndryshme që ne kemi në bachelor, janë regjistruar 810 studentë, pra 80 studentë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të shkuar".

Sallaku theksoi se, në Universitetin Bujqësor nuk do të mbyllet asnjë degë, duke marrë parasysh edhe raundin e dytë, ku numri minimal i nevojshëm me studentë do të plotësohet.

"Disa degë që vjet nuk u aktivizuan, siç ishte peshkimi apo zooteknia, sivjet të gjitha këto degë aktivizohen dhe vëmë re me kënaqësi që të rinjtë i janë kthyer këtyre programeve. Bëhet fjalë për programe të

cilat e kanë vendin e punës të garantuar, por mbi të gjitha janë programe për të cilat çdo i ri që regjistrohet do të marrë 40 mijë lekë në muaj, që është e barabartë me pagën minimale në Shqipëri", tha ai në një prononcim për mediet.

Krahas studentëve shqiptarë, Bujqësori do të presë këtë vit të ri akademik edhe studentë nga Italia.

Rektori bëri të ditur se, në datën 2 tetor, priten 20 studentë italianë që do të fillojnë në programet duale në Universitetin Bujqësor, në arkitekturë, inxhinieri pyjesh, teknologji ushqimore e në shumë programe të tjera.

Këtë vit të rinjtë kanë shfaqur më tepër interes për degët që janë cilësuar si prioritet kombëtar nga qeveria, duke ofruar për studentët që do të regjistrohen, bursë në vlerën e pagës minimale, pra 40 mijë lekë në muaj.

Duket se ky vendim ka ndikuar tek maturantët për t'i parë me sy më pozitiv këto degë, që vitet e fundit kishin mbetur në harresë.

STAFI I GAZETES

Kryetar i Bordit të Gazetës: Agim Rrapaj; **Bordi Drejtues: Zana Konini, Edmond Gjata, Shkëlqim Agolli, Ago Nezha, Enida Shena,**
Design & Layout: Elvira Çako Çeku; Asistente: Rozi Martini; Adresa: Rr."Mine Peza", P. 87/3, Hyrja 2, Kati 1, **Tel./ Fax**: ++ 355 4 2229445:
Web site: www.kashalbania.org E-mail: infokash@yahoo.com Llog. Bank.: TIRANA. BANK: AL092061100400001003018261 00; INTESA: AL75208110080000001023231803

IPARD - BE

FONDET IPARD TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR SHQIPËRINË

PASOJAT NEGATIVE QË PO SHKAKTON NGRIRJA E FONDEVE IPARD TË BE-SË PËR SHQIPËRINË, JANË TË PAPËRBALLUESHME DHE TË PARIPARUESHME PËR SUBJEKTET PRIVATE QË OPEROJNË NË FUSHËN E EKONOMISË SË USHQIMIT

Fermerët dhe subjektet private që janë angazhuar në fushën e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri, kohët e fundit po përballen edhe me pasojat e paripërueshme të ngrirjes së fondeve IPARD të BE për Shqipërinë. Të gjitha subjektet po punojnë prej vitit 2019 në kushte tejet të vështira. Ata vijojnë të përballen me pasojat negative që u shkaktoi tërmeti, pandemia Covid-19, konjuktura e rritur e çmimeve të mallrave të importuara, rritja e inflacionit, zhvlerësimi drastik i monedhave të huaja, lufta e Rusisë në Ukrainë, përkeqësimi i kushteve atmosferike, largimi i fuqisë punëtore nga zonat rurale, konkurenca e pandershme në eksport-import, mbështetja e limituar me grante dhe financimi i pamjaftueshëm nga bankat e nivelit të dytë, nga buxheti shtetit, e shoqëruar edhe me një paketë fiskale të padobishme.

Fondet IPARD II dhe III të BE-së dhe qeverisë shqiptare për fermerët dhe subjektet e tjera të fushës së Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri kanë qenë, janë dhe do të mbeten edhe në të ardhmen të një rëndësie jetike shumë të madhe sepse:

• Asistojnë subjektet e angazhuara në fushën e Ekonomisë së Ushqimit për përballimin e pasojave negative nga faktorët e sipërpërmendur që nuk varen prej tyre;

• Rrisin sigurinë ushqimore dhe aftësinë e sektorit agroushqimor për të përballuar pasojat negative të sipërcituara, si dhe për të përafruar progresivisht sektorin me standardet e BE, veçanërisht ato që lidhen me higjienën dhe mjedisin;

• Sigurojnë mbështetje për investime, përmes sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, që janë në përputhje me standardet e mirëqeverisjes së një administrate publike moderne, ekuivalente me ato në organizata të ngjashme në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian;

• Nxisin punësimin dhe reduktojnë varfërinë përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbajtjen e vendeve ekzistuese, përmes zhvillimit të aktiviteteve shtesë të biznesit, duke rritur kështu nivelin e aktivitetit ekonomik të zonave rurale dhe duke frenuar shpopullimin e zonave rurale në Shqipëri.

Fakti është që disbursimi fondeve të Programit IPARD II, për periudhën 2014 - 2020, me një buxhet 94 milion euro u realizua me sukses për katër masa: Masa 1, 3, 7 dhe 9 që janë;

1. Investimet në asete fizike të fermave bujqësore

3. Investimet në asete fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit

7. Investimet në asete fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.

9. Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit

Programi IPARD III i përgatitur me kujdes dhe i miratuar tashmë nga BE, për periudhën 2021 – 2027 parashikon mbështetje të sektorëve jo më në 4 por me 9 masa. Programit IPARD II i shtohen edhe 5 masa të reja, masa 4,5,6,10 dhe 11, me një buxhet nga BE dhe qeveria shqiptare prej 146 milion euro, që duke i shtuar dhe kontributin e sektorit privat financimi shkon në rreth 226 milion euro.

Masat e propozuara për programin IPARD III parashikojnë mbështetje për:

• Investimet në asete fizike të fermave bujqësore

• Investimet në asete fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit

• Masa Agro-mjedisore-klimatike dhe e bujqësisë organike

• Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER

• Investimet në infrastrukturën publike rurale

• Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit

• Asistencë teknike

• Shërbime këshilluese

• Ngritja dhe mbrojtja e pyjeve

Gjithashtu në ndryshim nga IPARD II në Programin IPARD III

Masës 1 i shtohet mbështetja për Bimët Mjekësore dhe Aromatike BAM-s dhe Ullinjtë .

Masës 3 i shtohet mbështetja për BAMs, vaj ulliri dhe përpunimi i peshkut;

Mbështetja dhe kontributi financiar për periudhën 2021 – 2027 në secilën masë nga BE dhe sektori publik dhe nga ai privat në Programin IPARD III është programuar dhe miratuar me rreth 226 milion euro.

Nga tabela si më sipër vërehet se sektori privat është programuar të kontribuojë financiarisht për realizimin e programit IPARD III vetëm në tre masa me shumën rreth 80 milion euro, ndërsa BE dhe Qeveria Shqiptare do të kontribuojnë përmes grantit në 6 masa me 100 % të shumës së programuar, dhe në total me rreth 146 milion euro.

Interesimi i sektorit privat për zbatimin e Programit IPARD II ka qenë shumë i madhe si rezultat i informacionit, promovimit, ndërgjegjësimit dhe domosdoshmërisë që kanë sektorët të cilët mbështet ky program. Sektori privat ka treguar se është tejet i interesuar për këtë program. Fakti që për një buxhet prej 94 milion euro të miratuar në Programin IPARD II, sektori privat paraqiti projekte me një kërkesë bashkëpunimi për financim në shumën 249 milion euro e tegon qartë interesimin.

AZHBR si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e programit IPARD ka vlerësuar si projekte të mundshme për financim të gjithë shumën e programuar prej 94 milion euro ose 100%.

Rezultati i disbursimit të financimit të Programit IPARD II nga AZHBR është shumë i mirë dhe institucioni duhet vlerësuar për punën e bërë në realizimin e këtij objektivi. Edhe për faktin se e ka arritur këtë rezultat si hera e parë që po zbatonin këtë program pas marrjes së besimit në autoritetet përgjegjëse në BE, përmes një pune intensive mjaft të vështirë, në harkun e 3 viteve 2018 – 2021 dhe jo në 6 vite si ishte programuar disbursimi i fondeve.

Programi IPARD II u ka shërbyer, vijon aktualisht dhe do të vijojë të japë frytet e veta pozitive dhe t'u shërbejë fermerëve dhe subjekteve që janë të angazhuar në fushën e ekonomisë ushqimit në Shqipëri, në disa nga sektorët kyç të kësaj fushe.

Procesi i zbatimit të Programit IPARD duhet vlerësuar si një proces tejet i vështirë dhe kompleks.

Mbështetja nga Programi IPARD II i qendrave të grumbullimit dhe përpunimit të lëndeve të para bujqësore e blegtorale bëri të mundur shtimin e tyre në sasi, përmirësimin në teknologji, reduktim të kostove duke arritur rezultate mjaft të mira dhe të qëndrueshme në eksport. Mbi 42 mijë fermerë që bashkëpunojnë me këto qendra grumbullimi e kanë siguruar tregun e shitjes së prodhimeve të tyre edhe në periudhat pik të prodhimit. Fermerët e tjerë që nuk kanë mundur të bashkëpunojnë po presin me padurim përfundimin disbursimin e fondeve të mbetura nga Programit IPARD II edhe fillimin e zbatimit të Programit IPARD III. Pa përfunduar disbursimin e fondeve të programit IPARD II dhe fillimin e zbatimit të Programit IPARD III nuk mund të përballohej dhe të përballohet në të ardhmen nga shumë subjekte konjuktura e rritjes së inflacionit, luhatjes së madhe të kursit të këmbimit të valutave të huaja me lekun, rritja galopante e çmimeve etj. faktorë negativë, që kanë ardhur edhe për shkak të tërmetit, pandemisë Covid 19, përkeqësimit të kushteve atmosferike dhe së fundi edhe të luftës së Rusisë në Ukrainë.

Theksuam që aplikimi dhe zbatimi Programit IPARD në Shqipëri dhe jo vetëm është mjaft kompleks në procesin e negociimit të marrëveshjeve dhe tejet i vështirë në atë të zbatimit për disbursimin e fondeve sipas marrëveshjeve të dakordësuara.

AZHBR, institucioni i akredituar që po e zbaton Programin IPARD edhe mund të ketë patur ndonjë parregullsi në procesin e vlerësimit dhe kontrollit, për shkak të përvojës së pamjaftueshme, pasi është e hera e parë që po zbaton një Program IPARD në mënyrë të pavarur, por dhe të intesitetit të lartë të procesit, për arësye të fillimit me vonesë të disbursimit, për shkak të fluksit të madh të aplikimeve dhe presionit të subjekteve të skualifikuara. Nuk duhet përjashtuar edhe presioni i atyre subjekteve që synojnë të përfitojnë kualifikim të pamerituar të projekteve, që nuk plotësojnë kriteret dhe që faktikisht nuk janë pak, por janë më shumë se ata që janë kualifikuar etj. Gjithashtu nuk mund të përjashtohen edhe raste të veçanta kur përfitues apo punonjës të pandërgjegjshëm dhe për interesa personale të kenë abuzuar me përgjegjësinë dhe detyrën e tyre në procesin e kontrollit dhe verifikimit të dokumentave. Për të parandaluar fenomenet negative të mësipërme dhe çdo fenomen tjetër negative, BE në Programin IPARD zbaton një sistem kontrolli, monitorimi dhe filtrimi mjaft rigoroz.

Filtrin e parë të procesit të kontrollit të disbursimit të fondeve e bën vetë AZHBR, mandej vijon procesi nga një zyrë e posaçme në Ministrinë e Financës dhe të Ekonomisë, si dhe kur ka ankesa angazhohen edhe të disa organeve të tjera të kontrollit të Shtetit Shqiptar dhe ajo pranë zyrës së Kryeministrit. Procesi vijon me monitorimin nga ekspertet e Zyrës së Delegacionit të BE në Tiranë dhe në fund miratimi përfundimtar për disbursimin e fondeve jepet nga Zyra për Bujqësinë DG Agri në Komisionin Europian në Bruksel. Pavarësisht të gjitha këtyre filtrave BE ka ngritur edhe një organizëm tjetër që kontrollon të gjitha institucionet e mësipërme të kontrollit, që është emërtuar si Zyra Kundër Mashtrimit me Fondet e BE ose shkurt OLAF.

Fondet e programit IPARD janë ngrirë për shkak të një informacioni për disa parregullsi në kontrollin e disbursimit të fondeve të Programit IPARD II nga zyra e OLAF. Pretendime që duhen evidentuar se akoma nuk janë ballafaquar me institucionet përkatëse dhe personat përgjegjës, që akuzohen se kanë gabuar, për këtë arësye edhe nuk janë bërë publike personat përgjegjës dhe rastet konkrete nga kjo zyrë.

Drejtori D.G Agri në Komisionin Europian në Bruksel ka dërguar një letër në MBZHR dhe në disa institucione të tjera ku shprehet se deri në përfundim të vlerësimit të raportit të kontrollit nga Zyra e OLAF në Shqipëri nuk do të japë miratimin përfundimtar, për disbursimin e fondeve të një fature të dërguar nga AZHBR prej rreth 430 mijë euro. Gjithashtu duke e ngrirë përkohësisht edhe procesin për fillimin pa humbur më shumë kohë të praktikës së disbursimit të fondeve të Programit IPARD III.

Menaxhimi i procesit për miratimin e raportit përfundimtar të zyrës së OLAF është me shumë rëndësi për fermerët dhe subjektet shqiptare që punojnë në fushën e ekonomisë së Ushqimit dhe jo vetëm. Si dhe ata që kanë aplikuar apo presin të aplikojnë, për të bashkëpunuar me Programin IPARD. Dëmi që po u shkaktohet nga politizimi i tejskajshëm i letrës së dërguar për ngrirjen e fondeve nga DG Agri në Bruksel, duke i bërë thirrje BE përmes medias, për ndërprerjen e fondeve Shqipërisë jo vetëm të Programit IPARD, por edhe atyre IPA në tërësi, është shumë i madh për të gjithë pa përjashtim dhe i paripërueshëm. Akuzat për korrupsion të artikuluara politikisht në media të ndryshme pa prova dhe fakte dhe të pagjykuara nga organet ligjzbatuese me vendime përfundimtare veçse dëmtojnë fermerët dhe subjektet e fush-

(Vijon në faqen 4)

Masat	Totali mbështetjes publike (Euro)	Kontributi privat (Euro)	Totali shpenzimeve (Euro)
1.Investime në aktive fizike në fermat bujqësore	41,973,333	23,610,000	65, 583,333
2.Investime në aktive fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	40,480,000	40,480,000	80,960,000
3.Masa agro-mjedisore-klimaterike dhe e bujqësisë organike	2,528,235	0	2,528,235
4.Zbatimi strategjive të zhvillimit lokal – LEADER	4,800,000	0	4,800,000
5.Zbatimi në Infrastrukturën Rurale Publike	16,000,000	0	16,000,000
6.Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit	28,434,667	15,310,974	43,745,641
7.Asistenca Teknike	2,235,294	0	2,235,294
8.Shërbimet këshillimore	2,900,000	0	2,900,000
9.Pyjet	7,058,824	0	7,058,824
Total	**146,410,353**	**79,400,974**	**225,811,327**

Kryeministri Edi Rama foli në një intervistë televizive për pezullimin e fondeve të BE-së për Bujqësinë. Rama tha se nuk ka të dhëna për këtë çështje dhe se është në pritje të një raporti nga BE.

"Ajo është një çështje që ne do ta shikojmë konkretisht. Nuk kemi asnjë të dhënë konkrete se do duhet të presim raportin që do të vijë nga BE, por është një shenjë e një vullneti të mirë për të qenë të hapur komplet në këtë marrëdhënie me BE dhe për t'u krijuar atyre dhe vetes komoditetin e një komunikimi lidhur me problematikat dhe me adresimin e tyre pa pasur ngërçin e një ministri, në këtë rast të ministres që në këndvështrimin tim, ka bërë një punë të jashtëzakonshme si ministre e Bujqësisë, që lidh periudhën e qëndrimit të saj në detyrë me periudhën kur janë konstatuar këto probleme. Është normale të jetë kështu, ndryshe do kishte një ngërç në këtë marrëdhënie dhe s'kemi pse ta kemi. Ne duam të përmirësohemi. Nuk diskutohet që janë konstatuar probleme, ato probleme duhet të adresohen dhe sistemi i funksionimit duhet të përmirësohet. Duam të bëjmë maksimumin nga ky proces", deklaroi Rama.

AKTUALITET

AZHBR: Asnjë shkresë përfituesve për kthimin e fondeve të programit IPARD II

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) informoi publikun se nuk ka nisur asnjë shkresë drejt përfituesve për kthimin e fondeve të Programit IPARD II.

Në një njoftim për shtyp, AZHBR reagoi pas disa lajmeve në medie të ndryshme vizive dhe të shkruara, për kërkesën e kthimit të fondeve nga përfituesit e programit IPARD.

AZHBR bëri të ditur se "në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, Marrëveshjes Sektoriale, Programit IPARD II të miratuar, si dhe në zbatim të manualeve të brendshme të funksionimit të saj, u dërgon shkresa njoftuese periodikisht (çdo 6-12 muaj) subjekteve përfituese, për t'i rikujtuar zbatimin e detyrimeve kontraktuale që rrjedhin nga kontrata e grantit me AZHBR".

Sipas AZHBR-së, kjo është një procedure standarde e cila i shërben përfituesve të programit dhe garantimit të funksionalitetit të investimit deri në 5 vite pas pagesës përfundimtare.

"Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, nuk ka nisur shkresa njoftuese për kthimin e fondeve drejt përfituesve të programit IPARD II, në rast se këto subjekte nuk kanë shkelur dispozitat kontraktuale, apo nuk janë shpallur debitore nga AZHBR", thuhet në njoftim.

AZHBR fton mediet e interesuara që të kërkojnë informacion të plotë dhe shterues pranë AZHBR për çështje të tilla të ndjeshme që kanë të bëjnë me informimin e publikut dhe jo të dezinformojnë atë.

"Për çdo kërkesë mbetemi në dispozicionin tuaj duke ju garantuar informacion të plotë dhe transparent", thuhet në njoftimin për shtyp të AZHBR-së.

Skema kombëtare 2023, AZHBR: 7624 blegtorë janë financuar deri tani

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural bën të ditur se, 7624 blegtorë janë financuar deri më tani në kuadër të Skemës Kombëtare të Mbështetjes 2023.

Këtë vit, blegtoria mbështetet përmes dy masave subvencionuese, për tufën bazë të matrikulluar (gjedhë) dhe për tufën bazë të matrikulluar (të imta).

Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2023 do financojë të gjithë blegtorët që kanë aplikuar për subvencione dhe operojnë në sektorin e prodhimit të qumështit, për shtimin e numrit të krerëve dhe të prodhimit.

Sipas AZHBR-së, këtë vit kanë aplikuar 8618 blegtorë për subvencione përmes Skemës Kombëtare 2023.

Krahasuar me një vit më parë, numri i aplikantëve është rritur me gati 2470 blegtorë, shifër kjo pothuajse e njëjtë me tre vite më parë.

Qeveria shqiptare po vijon prej disa vitesh me radhë mbështetjen e këtij sektori me subvencione.

Referuar statistikave të AZHBR, për vitin 2022 Skema Kombëtare financoi 6211 blegtorë, me një fond prej 1,52 miliardë lekësh, me qëllim rritjen e prodhimit dhe standardeve për këtë sektor bazë të ekonomisë në vend.

Vitin e kaluar prodhimi i qumështit në vend arriti në 970 mijë tonë.

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar parashtron fakte mbi rëndësinë e programit IPARD në zhvillimin e bujqësisë. Sektori privat ka treguar se është tejet i interesuar për këtë program

(Vijon nga faqja 3)

ës së ekonomisë së ushqimit në këto ditë tejet të vështira për ta.

Zgjidhja më e mirë në këtë situatë për Shqipërinë do të ishte vlerësim e përkrahje për të gjithë ato subjekte dhe individë, që kanë punuar mirë në zbatimin dhe disbursimin e fondeve të programit IPARD II dhe përgatitjeve për programin IPARD III. Punën e tyre të mirë që është bërë deri tani me disbursimin 100 % të fondeve të Programit IPARD II dhe përgatitjeve në kohë të IPARD III nuk mund ta errësojnë raste sporadike parregullsish.

Ngrirja fondeve dhe frenimi i procesit të zbatimit të programit IPARD në Shqipëri nuk i intereson as BE-së, që ka hapur procesin e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe askujt në Shqipëri, që është i interesuar për fermerët dhe subjektet që janë angazhuar për përparimin dhe integrimin e Shqipërisë në strukturat euro-atlantike.

Ngrirja e procesit të disbursimeve të fondeve të IPARD do të sjellë vetëm pasoja negative të pariparueshme për të gjithë. Raporti përfundimtar me gjetjet e OLAF duhet të analizohet pa humbur kohë dhe të marrim masa të menjëhershme, për gjithçka të dakordësuar që duhet riparuar. Gjithashtu të ndëshkohet sipas rastit dhe pa asnjë hezitim, cilido që ka gabuar nga paaftësia apo ka abuzuar me detyrën për qëllime përfitimi të pamerituara.

KASH (Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar)

Rama: Akuakultura vlerë e shtuar e ekonomisë blu, rritet në 30 mijë tonë prodhimi i peshkut

Skema mbështetëse ndaj sektorit të peshkimit me teknologji të reja dhe subvencionimin e naftës kanë nxitur rritjen e eksporteve të produkteve të peshkut.

Nga ana tjetër edhe akuakultura konsiderohet vlerë e shtuar e ekonomisë blu.

Ndërsa u ndal në këtë degë të industrisë së peshkimit, Kryeministri Edi Rama theksoi se po vijon rritja e niveleve të prodhimit në det me kosha notues.

Sipas tij, "kapaciteti i prodhimit parashikohet të shkojë rreth 30 mijë tonë, në funksion të eksporteve shqiptare nga Europa në Japoni, si edhe të tregut vendas.

Sektorit të peshkimit vitet e fundit i janë krijuar një sërë lehtësish fiskale, si heqja e akcizës për karburantin, heqja e taksës së karbonit, zero TVSH për rrjetat, anijet, pajisjet elektronike, zero TVSH frigoriferëve, motorëve të anijeve të peshkimit.

Ndërsa investimet, të kombinuara me kërkesën në rritje të tregut të huaj, kanë sjellë rritje progresive të eksportit.

Rritja e eksporteve në këtë segment erdhi pas zgjerimit të investimeve, falë mbështetjes së programeve që adresoi qeveria për financimin e industrisë së peshkut.

Gjithashtu rol të rëndësishëm ka luajtur edhe përmirësimi i infrastrukturës në portet e peshkimit, si edhe ndërtimi i markatave të reja për tregtimin e peshkut, që ka shtuar vlerën e këtij produkti në tregje.

Sot eksporti i peshkut ka shënuar një rritje të shumëfishtë. Në krahasim me 2013-ën eksportet janë rritur 4 herë më shumë. Në 2022 u eksportuan mbi 9219 tonë prodhime deti.

Parku i bletëve me 150 koshere në Zall-Herr me mbështetjen e AZHBR-së

Me përvojën e 25 viteve pune në bletari, Gëzim Boka ka ngritur një park bletësh me 150 koshere, në Zall-Herr, Tiranë. Bletaria, përveçse një aktivitet që i sjell të ardhura, është një pasion që ai e ka ruajtur dhe e vazhdon prej shumë vitesh.

Gëzimi është një ndër përfituesit e masës për mbarështimin e bletarisë, nga Skema Kombëtare 2023, ku për të katërtin vit radhazi ka aplikuar dhe është subvencionuar nga kjo skemë. Nga një koshere përfiton një sasi prej 7-10 kg mjaltë në vit, por edhe qumështin e bletës, propolisin, të cilat janë shumë të kërkuara në treg.

AZHBR përmes Skemës Kombëtare synon të mbështesë të gjithë bletarët në rritjen e sasisë, cilësisë dhe lehtësimin e kostove gjatë prodhimit.

Sfidat për mbrojtjen e mjedisit në Ballkanin Perëndimor

Për të analizuar nga perspektiva të ndryshme ruajtjen e natyrës duke ndjekur parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut 25 anëtarë të Shoqatës Gjermane për Europën Juglindore zhvilluan një udhëtim studimor, gjatë të cilit eksploruan disa nga peizazhet më të spikatura dhe pikat më të nxehta të biodiversitetit në këto vende dhe në rajonet kufitare mes tyre.

Në kuadër të udhëtimit studimor u zhvillua në Prizren edhe konferenca "Biodiversiteti dhe Ruajtja e Natyrës në Ballkanin Perëndimor". Prizreni ndodhet në skajin jugor të Malësisë së Sharrit. Parku Kombëtar i Sharrit është pjesë e një prej zonave të mbrojtura më të mëdha në Europë, që shtrihet në tri vende: Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Lumi i Vjosës ka marrë një vëmendje të jashtëzakonshme ndërkombëtare, si një lumë që ka një biodiversitet të jashtëzakonshëm dhe mbi të gjitha, sepse është i pa ndërprerë gjatë gjithë rrjedhjes së tij, që nga burimi deri në grykëderdhje. Në Vjosë ka mbi 250 lloje shpezësh të pranishme. Mbi 150 lloje janë të listuara në konventën e Bernës si lloje të mbrojtura dhe me interes të lartë për ruajtjen.

Por Aleksandër Trajçe, drejtor ekzekutiv i OJQ-së Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), u shpreh se "ishte zhgënjim i madh që në shpalljen e Vjosës park kombëtar, u la jashtë parkut kombëtar pjesa e deltës së lumit Vjosa, si pjesa më biodiverse e parkut kombëtar. Për ne është shumë e qartë se kjo është bërë për shkak përfitimi, pasi në deltën e lumit Vjosa që prej fund të vitit 2021 po ndërtohet aeroporti ndërkombëtar i Vlorës, i cili është një investim jo vetëm që po rrezikon ekosistemin të pjesës me biodiversitetin më lartë të Vjosës."

Kjo do të ndërpresë edhe një rrugë migratore që mijëra shpendë e përdorin për të migruar nga Evropa në Afrikë, ajo që quhet rruga e migrimit të Adriatikut (adriatic flight way). Pra nuk është vetëm ekosistemi i deltës së Vjosës apo natyra Shqipërisë që po dëmtohen, por prej ndërtimit të këtij aeroporti i bëhet një dëm i jashtëzakonshëm gjithë kontinentit evropian dhe më gjerë.

Trajçe kërkon që të ndalohen menjëherë punimet për këtë aeroport dhe të gjenden zgjidhje alternative për këtë situatë. "Ai aeroport do të sjellë një dëm të pariparueshëm për natyrën e Shqipërisë."

Ndër temat që u trajtuan në konferencë ishte edhe çfarë mund të bëjnë mediat për të përhapur dhe ngritur vetëdijen për mjedisin dhe mbrojtjes së natyrës në Ballkanin Perëndimor.

INFORMACIONE

Shqipëri-Çeki, bujqësia një nga sektorët prioritarë në bashkëpunimin mes dy vendeve

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar Agim Rrapaj dhe Ines Muçostepa, presidente e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, me ftesë të ambasadorit çek në Shqipëri, Karel Urban, zhvilluan në ambasadën e Republikës Çeke në Tiranë, një takim zyrtar me delegacionin e përfaqësuesve të lartë të Dhomës së Senatit të Parlamentit të Republikës Çeke

Një delegacion i përfaqësuesve të lartë të Dhomës së Senatit të Parlamentit të Republikës Çeke, vizituan vendin tonë ditët e fundit dhe zhvilloi takime me përfaqesuesit e autoriteteve shqiptare dhe të komunitetit të biznesit dhe agrobiznesit.

Në ambasadën e Republikës Çeke në Tiranë, Karel Urban, ambasadori i Çekisë në Shqipëri dhe përfaqësuesit e Senatit Çek, pritën në një takim pune krerët e biznesit shqiptar kryetarin e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj dhe Ines Muçostepa, presidente e Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

Rrapaj falenderoi ambasadorin çek, për ftesën e bashkëpunimit, si dhe i uroi mirëseardhjen delegacionit qeveritar dhe përfaqësuesve të bizneseve çeke në Shqipëri.

Teksa vuri theksin te marrëdhënia e fortë që ekziston ndërmjet dy vendeve tona, Rrapaj u ndal edhe te potencialet e ekonomisë bujqësore që Shqipëria ofron, si një vend me shumë mundësi agrobiznesi.

My synimin për të intensifikuar dialogun ndërmjet sipërmarrjeve dhe për të shkuar drejt konkretizimit të projekteve të përbashkëta, Rrapaj shprehu gatishmërinë e KASH për zgjerimin e investimeve çeke në sektorin rural shqiptar.

Kreu i KASH solli në vëmedje historikun e një bashkëpunimi të sukseshëm mes dy vendeve në fushën e bujqësisë dhe prioritetet e reja që parashtron ky sektor sot dhe ku do të fokusohet mbështetja e investitorëve çekë në ndihmë të zhvillimit të bujqësisë shqiptare.

"Vlerësuam edhe ecurinë pozitive të bilancit tregtar midis dy vendeve në fushën e bujqësisë dhe mundësitë për investime në fusha potenciale të sektorit rural me interes reciprok" tha Rrapaj.

"Ndër të tjera, theksoi kreu i KASH, diskutuam për bashkëpunime potenciale që kanë të bëjnë me kulturat bujqësore me avantazh konkurrues të vendit tonë, si dhe aktivitete bujqësore të lidhura me turizmin, siç është agroturizmi"

Etnogatimet, tradita në zonat e Fustanellës

Fustanella është një nga restorantet e reja në periferi të Tiranës. Një vit para pandemisë, restoranti hapi dyert dhe me një risi u ofruan në treg etnogatimet.

Pjatat e shërbyera në kuzhinat e çdo vendi që përdor fustanellën.

Ferma në lagjen Zarnik të Petrelës ofron kuzhinë mesdhetare dhe ballkanase, duke ndjekur dhe duke riinterpretuar receta tradicionale të gatuara për shekuj me radhë në vatrat e shtëpive, ku vishej dhe ende vishet fustanella.

Themeluesit e Fustanella Farm, Johana Bano dhe Bland Ashiku, japin një pasqyrë më të qartë të kësaj risie dhe përfaqësimit të recetave autentike si te vendasit, edhe te të huajt.

Si ka ndryshuar klientela juaj gjatë viteve të fundit dhe a ka ndikuar turizmi në këtë shifër?

Ne kemi një klientelë fikse, kryesisht vendase, por edhe të huaj që jetojnë në Shqipëri.

Sigurisht, ashtu si restorantet e tjera, edhe ne frekuentohemi nga turistët dhe mund të themi që numri i tyre në restorantin tonë është rritur me 20% këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar.

Natyrisht që shumica e tyre vjen si pasojë e bashkëpunimit me agjencitë, por kemi pasur rritje edhe të numrit të turistëve që na gjejnë vetë.

Çfarë ndryshimesh keni bërë në menunë tuaj për t'iu përshtatur më shumë kërkesave të turistëve, por edhe prodhimit vendas?

Ne kemi opsione si vegane edhe vegjetariane, për t'u përshtatur me kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve.

Për 12 muaj, ne përpiqemi që produktet kryesore t'i mbulojmë me fermën tonë. Menuja është e stinës dhe e bazuar drejtpërdrejt në prodhimet e parcelave që rrethojnë restorantin dhe bujtinën.

Prodhimet e mishit sigurohen në ferma të tjera të ngjashme, që kanë përparësi blegtorinë.

Gatimet bëhen vetëm me prodhime të freskëta stinore, të kthyera në një menu ditore ose javore, me specialitete shqiptare, greke, arbëreshe, të cilat kombinohen me meze të stinës, shumë të dashura për ballkanasit e jugut.

Pjatat shoqërohen nga disa varietete të zgjedhura verërash dhe distilatesh, kryesisht vendase, lëngje të freskëta të frutave, komposto të bëra vetë dhe çaje organikë.

Plantacion i vetëm i shegëve izraelite në Myzeqe jep prodhimin e parë

Në Divjakë shega ka nisur të kultivohet masivisht, por së fundmi një nga fermerët e zonës ka arritur të sfidojë importin duke sjellë një varietet të veçantë shege i cili piqet në fund të Gushtit dhe vazhdon deri në Shtator. Zakonisht shega njihet si fruti i vjeshtës, por këtu në Divjakë tani është kthyer edhe në frutin e verës.

Pas 27 vitesh në emigracion, Llambi Sota vendosi që të kthehej në vendlindje, në fshatin Mucjas të Divjakës, dhe ndërtoi këtë plantacion shegës. Pas 4 vitesh punë mori prodhimin e parë të këtij variteti të vecantë. Bimët kanë ardhur nga përtej Adriatikut, nga Italia. Piqet më herët duke dalë edhe më shpejt në treg.

"Kjo shegë është marrë në Itali. Është një varietet nga Izraeli dhe vjen në fund të Gushtit dhe fillim të Shtatorit. Kemi marrë edhe një varietet tjetër që vjen 10 ditë më para, vjen nga data 20 Gusht."

Këtij varietit të shegës i janë dashur 4 vjet për të dalë në prodhim. Llambi është i kënaqur me cilësinë ndërsa edhe çmimi është i leverdisshëm. Ai na tregon se një kg të këtij fruti e ka shitur deri me 280 lekë.

"Kërkesa shega ka. Deri tani me tregun jemi mirë. Nuk e di se si do vejë më vonë, por shpresoj që të jetë kështu.

"Me sa e ke nisur tregtinë?"

"Me 280, sot shega është me 200, 220."

Ai punon në këtë plantacion bashkë me bashkëshorten. Gjatë gjithë vitit i bëjnë shërbimet pemës dhe tani është periudha e vjeljes. Prodhimi shkon kryesisht në tregun vendas.

"Për tregun vendas deri tani merr Tirana, Durrësi, Korça edhe Lushnja."

Për t'i ndihmuar ka ardhur nga Italia edhe djali i tyre.

"Si ky prodhimi i shegëve a ke parë të ngjashëm në Itali?"

"S'kam parë të them të drejtën. Hera e parë që kam parë në Shqipëri se s'kam punuar në këtë ambjent dhe them që jemi shumë para me të tjerët. Shpresoj të jemi sa më mirë edhe ne prodhim edhe në çdo gjë."

Prodhimi i këtij varieti vazhdon deri në Dhjetor. Për shkak të klimës në Divjakë kultivohen pemë që nuk mbillen në zona të tjera të vendit. Edhe ky plantacion me shegë nga Izraeli është i vetmi në Shqipëri.

Akademia e Shkencave marrëveshje me Akademinë e Shkencave Bujqësore e Pyjore të Rumanisë

Një delegacion i Akademisë së Shkencave Bujqësore dhe Pyjore të Rumanisë, vizitoi sot Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Delegacioni nga ASHBP rumune, Joan Jelev dhe Marian Bogoescu, u prit nga kryetari i Akademisë së Shkencave, Skënder Gjinushi, Vasil Tole zëvendëskryetar i ASH dhe akad. Shaban Sinani.

Gjinushi dhe prof. Joan Jelev, zëvendëskryetari i ASHBP, Jelev bënë të njohur strukturën, misionin dhe rolin e dy akademive në jetën shkencore të vendit.

U formalizua marrëveshja e bashkëpunimit midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave Bujqësore e Pyjore të Rumanisë (ASHBP).

Marrëveshja është nënshkruar paraprakisht përmes korrespondences, për shkak të kufizimeve nga pandemia. Ajo përmban shkëmbime të informacionit shkencor të botimeve akademike, të ekspertëve dhe ekspertizave, rol lehtësues në bashkëpunimin me institucione të tjera në dy vendet, projekte të përbashkëta dypalëshe dhe në kuadër të "Euro-2020".

Sot delegacionet diskutuan për mundësi bashkëpunimi më të gjerë, që përfshijnë institucione akademike e universitare në Shqipëri, Rumani e Moldavi.

Në ditën e parë të kësaj vizite u zhvillua konferenca shkencore "Agriculture and its future in the region" (Bujqësia dhe e ardhmja e saj në rajon).

Problematika e konferencës përfshin vlerësimin e burimeve natyrore agrobujqësore, modernizimin e prodhimit bujqësor, ruajtjen e informacionit gjenetik vendor, kontrollin mbi kimikatet etj.

Delegacioni i ASHBP të Rumanisë do të qëndrojë tri ditë në Tiranë dhe do të ketë kontakte bashkëpunimi me UT dhe UBT.

Marrëveshja me Malin e Zi për sigurimet shoqërore, Buxheli: Përfitojnë 560 shqiptarë

Kuvendi diskutoi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi, për sigurimet shoqërore".

Duke marrë fjalën në seancën plenare të Kuvendit, Lindita Buxheli relatore e çështjes, e cilësoi këtë projektligj të një rëndësie të veçantë që i vjen në mbështetje të gjithë të punësuarve respektivisht në të dy vendet për njohjen e sigurimeve shoqërore.

"Nga të dhënat rezulton se janë 560 shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Malin e Zi dhe 35 qytetarë malazezë që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri, të cilët përfitojnë menjëherë pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të këtij projektligji", tha ajo.

Buxheli informoi se, me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje qytetarët do t'u njihen vitet e pensioneve të pleqërisë, përfitimet për sëmundje, barrëlindje, dëme të shkaktuara gjatë punës, por edhe përfitime të papunësisë.

TË NDRYSHME

Portofoli Zviceran për arsimin profesional nis fazë të re deri në 2027-ën

Një bashkëpunim i ri filloi mes dy projekteve për arsimin dhe formimin profesional të financuara nga Zvicra dhe të zbatuara nga UNDP dhe Swisscontact në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Projektet e Programit të Zhvillimit të Aftësive për Punësim (SD4E) dhe Skills for Jobs (S4J) kanë përafruar tashmë kuadrin e tyre të aktiviteteve dhe do të integrojnë më tej mbështetjen e tyre për sektorin e arsimit profesional në Shqipëri. Ky portofol i përbashkët do të sigurojë që ndërhyrjet të krijojnë sinergji për më shumë ndikim.

"Jam i lumtur që jemi sot këtu të gjithë së bashku për të festuar fillimin zyrtar të të dy projekteve dhe ju uroj suksese në zbatimin e tyre. Falë bashkëpunimit të plotë ndërmjet SD4E dhe S4J, shpresojmë të realizojmë sinergji të mëtejshme duke synuar një transferim të qëndrueshëm të arritjeve tona të përbashkëta", tha Philipp Arnold, zëvendësshef i Misionit në Ambasadën e Zvicrës.

Monica Merino, Përfaqësuesja e Përhershme e PNUD-it tha se, "ky rrugëtim i suksesshëm dhe sfidues drejt ndryshimit sistematik në fushën e zhvillimit të aftësive profesionale nuk ka përfunduar ende, por është dhënë një kontribut i rëndësishëm. Disa procese janë duke u zhvilluar për të siguruar që rezultatet të jenë të qëndrueshme dhe të përmirësohen më tej, si dhe të transferohen njohuritë dhe ekspertiza. Kjo është arsyeja pse është një mundësi e shkëlqyer për dy projektet tona që të vazhdojnë të kontribuojnë në nivelin e politikave dhe të ofrimit. Falënderojmë Ministrinë e Financave për partneritetin dhe qeverinë zvicerane për angazhimin e gjatë thelbësor".

"Në Swisscontact, vlerat tona thelbësore janë të lidhura ngushtë me partneritetin e vazhdueshëm me sektorin privat. Përfshirja e tyre aktive shërben si garanci për arsim dhe trajnim profesional me cilësi më të lartë (AFP) dhe është thelbësore në avancimin e agjendës së kapitalit njerëzor të Shqipërisë", tha Cuan Opperman, drejtor i "Swisscontact Albania".

Të dy projektet punojnë për të siguruar që arsimi dhe aftësitë profesionale të përmirësohen në atë shkallë që të rinjtë shqiptarë të jenë të përgatitur për një punësim fitimprurës dhe të denjë. SD4E fokusohet më shumë në nivelin e politikave dhe në forcimin e kapaciteteve të ministrive të linjës dhe agjencive qeveritare, ndërsa S4J fokusohet në përmirësimin e ofertës së institucioneve profesionale dhe bashkëpunimin e tyre me sektorin privat. Me fazën e re, të dy projektet kanë rinovuar planet e tyre për periudhën 2023-2027 dhe kanë harmonizuar ndërhyrjet e tyre të planifikuara për të siguruar më shumë impakt.

Në këtë fazë të re projektet kanë një lidhje më të ngushtë me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive të Shqipërisë 2030 dhe aktivitetet e tyre do të kontribuojnë në përmirësimin e zhvillimit ekonomik dhe punësimit.

Aktivitetet do të zbatohen në partneritet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit Profesional, Formimit dhe Kualifikimeve.

Siguria ushqimore, AKU 16 njoftime në sistemin e alarmit të BE-së

Sistemi europian për sigurinë ushqimore RASFF (Sistemi i Njoftimit të Shpejtë për Ushqimin dhe Ushqimin për kafshë) mundëson informimin efikas midis vendeve anëtare në lidhje me situatën epizotike për sigurinë ushqimore, si dhe marrjen e masave përkatëse nga çdo shtet për rastet që paraqiten.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në vijim të njoftimeve të ardhura nga BE për Shqipërinë nëpërmjet sistemit RASFF gjatë periudhës janar-gusht 2023 shënon 23 njoftime të ardhura, ndërsa për të njëjtën periudhë për vitin 2022 shënohen 30 njoftime.

Referuar njoftimeve të dërguara nga Shqipëria drejt RASFF për periudhën janar-gusht 2023 Shqipëria ka kryer 16 njoftime.

Treguesi në rritje i marrjes së mostrës dhe kontrollit vendas, është reflektuar me katërfishim të njoftimeve në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

AKU bën të ditur se, intensifikimi i këtij bashkëpunimi është i lidhur ngushtë edhe me punën që po bëhet për përmbushjen e detyrimeve në drejtim të sigurisë ushqimore, për procesin e integrimit të vendit në BE, e cila po vijon me rigorozitet dhe profesionalizëm të lartë, falë edhe shkëmbimit të eksperiencave dhe trajtimeve të ndryshme edhe me ekspertët ndërkombëtar.

BE-ja ka një nga standardet më të larta të sigurisë ushqimore në botë, kjo falë grupit solid të legjislacionit të BE-së në fuqi, për të mbajtur ushqimin të sigurtë. Si pjesë e mjeteve të sigurisë ushqimore, sistemi i alarmit të shpejtë për ushqimin dhe ushqimin (RASFF) u krijua për të siguruar shkëmbimin e informacionit midis vendeve anëtare për të mbështetur reagimin e shpejtë nga autoritetet e sigurisë ushqimore në rast të rreziqeve për shëndetin publik që vijnë nga zinxhiri ushqimor.

Shqipëria është anëtare në RASFF me të drejta dhe përgjegjësi të plota.

Turistët "rrëzojnë" kullat dhe ushqimet e huaja, kërkojnë traditë; Si po nxisin modele të reja biznesi

Turistët po bëhen ambasadorë të papritur të kulturës së vendit. Nga panairet e shumta të zejtarisë te koncertet e muzikës folklorike, përfshirë degustimet e kuzhinës tradicionale dhe te netët shqiptare në hotelet e shumta të bregdetit, turistët kërkojnë gjithmonë e më shumë identitetin e vërtetë shqiptar. Larg kullave, familjet tiranase po tentojnë të zbatojnë projektin "Portat e Hapura", me promovimin e vilave tradicionale. Nga kuzhina e huaj, lokalet po kalojnë te ushqimi tradicional. Si ringjallja e traditës po krijon modele të reja biznesi.

Kur e gjithë Tirana po mbushet me kulla dhe shtëpitë e vjetra po shemben, duke ua lënë vendin qiellgërvishtësve, Xhimi Begeja, mjeshtri i madh i sportit të alpinizmit, pjesëtar i një prej familjeve më të vjetra të Tiranës, kujton fjalët që i pati thënë gjyshi kur ishte i vogël.

"Floriri është poshtë këmbëve, po s'ia dimë kimetin", pohon ai, teksa na tregon banesat e vjetra të familjes së tij. "Atëherë nuk e dija për çfarë e kishte fjalën, tani e kuptoj mirë".

Z. Begeja thotë se tani e di që floriri ishte trashëgimia, historia e lënë nga paraardhësit. Me këtë mirëkuptim të ri, ai dhe familja e tij janë përpjekur të ruajnë sa më mirë vilat e vjetra që kanë trashëguar, duke i rindërtuar dhe duke u dhënë atyre jetë si më parë, sidomos tani që vendi po përjeton një lulëzim turistik dhe interesimi i të huajve për trashëgiminë e vendit po rritet dita-ditës.

Dëshira e Xhimit dhe e familjes së tij për të ruajtur çfarë ka mbetur nga historiku arkitekturor i Tiranës është shtrirë përtej asaj çfarë ata zotërojnë. Së bashku me disa nga fqinjët e tij, teksa pinin kafenë e mëngjesit, vendosën që "floriri" i tyre të ruhej dhe t'u shfaqej të tjerëve si atraksion.

Ata menduan për një qytezë të vjetër që Tirana si kryeqytet europian nuk e ka.

Pse Censi nuk përfshin bujqësinë? - Vitin e ardhshëm nis një tjetër "numërim". "Dalin në dritë" fermerët

Censi i popullsisë dhe i banesave i cili ka nisur më 18 shtator, nuk do të përfshijë sektorin e bujqësisë dhe të blegtorisë. Kjo për arsye se INSTAT parashikon që ky të jetë një proces më vete.

Konkretisht, në vitin 2024, pas Censit të popullsisë, parashikohet që të nisë implementimi i Censit të Bujqësisë, i cili do të luajë rol vendimtar në përditësimin e informacionit statistikor të nevojshëm në nivel lokal dhe rajonal dhe pasqyrimin e ndryshimeve në që kanë ndodhur në këtë sektor në më shumë se një dekadë.

Censi do të kontribuojë gjithashtu në krijimin e regjistrit statistikor të fermave, i cili do të jetë burimi i vrojtimeve me karakter bujqësor në të ardhmen. Aktualisht, INSTAT ka filluar fazën parapërgatitore për realizimin e këtij ushtrimi.

Fillimisht është përgatitur një modul pyetjesh të cilat janë



përfshirë në pyetësorin e censit të popullsisë dhe banesave me qëllim krijimin e listës së fermave bujqësore, e cila do shërbejë kornizë për Censin e ardhshëm të njësive ekonomike bujqësore, kjo për arsye të mungesës së regjistrit administrativ të fermave.

INSTAT parashikon të mbledhë edhe module të veçanta në të gjithë fermat bujqësore që kanë të bëjnë me ujitjen, praktikat e menaxhimit të tokës, makineritë, pajisjet dhe pemëtarinë.

Ky proces ishte planifikuar që të kryejnë vitin 2022, por për shkak të pandemisë, u shty për vitin e ardhshëm.

FED INVEST

Përvoja e FED invest-it në Konferencën EFSE DF, si kampion në përfshirjen financiare të fermerëve dhe sipërmarrësve të vegjël në Shqipëri, nëpërmjet modelit të financës sociale

Në Konferencën e Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF), Perlat Sulaj, Administrator i FED invest-it, mori pjesë si panelist në sesionin "Përputhja midis fitimit dhe kujdesit për mjedisin në sektorin bujqësor"

Në Konferencën e Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF), me temë: "Të investosh për të mirën e përbashkët: Risqet e ESG ndaj Kthimit", mbajtur në Sarajevë më 18-19 shtator 2023, z. Perlat Sulaj, Administrator i FED invest-it, mori pjesë si panelist në sesionin "Përputhja midis fitimit dhe kujdesit për mjedisin në sektorin bujqësor"

Z. Sulaj ndau përvojën e FED invest-it si kampion në përfshirjen financiare të fermerëve dhe sipërmarrësve të vegjël në Shqipëri, nëpërmjet modelit të financës sociale.

Krahas një game të gjerë të produkteve të kredisë dhe depozitave, FED invest u ofron këtyre segmenteve llogari rrjedhëse, overdrafte, pagesa të shërbimeve utilitare, si dhe aplikime online. Gjatë diskutimit të tij, z. Sulaj e vuri theksin tek shërbimet e Qendrës ABA dhe platformës abaonline.al, duke theksuar rolin e tyre thelbësor për ekspertizën agri, edukimin financiar dhe promovimin e praktikave më të mira për një fermë të qëndrueshme.

Z. Sulaj theksoi rolin thelbësor të partnerëve strategjikë si EFSE DF dhe Rabo Partnership në mbështetjen e misionit dhe objektivave të FED invest.

Fokusi i FED invest-it është angazhimi për mbështetjen e aktorëve me qëllim zhvillimin e një sektori bujqësor të qëndrueshëm dhe të suksesshëm.

Në kalendarin e mikrofinancës, 25 Janari 2022 përkoi me 20-vjetorin e themelimit të Unionit Shqiptar Kursim Kredi dhe 30-vjetorin e mikrofinancës në Shqipëri.

Në këtë rrugëtim të mikrofinancës ka pasur një ringjallje ekomike dhe një zhvillim të konsiderueshëm të zonave rurale, gjykuar kjo sidomos në aspektin e fermave bujqësore dhe aktiviteteve të ndryshme prodhuese, që janë karakteristike për fshatin.

Dhënia e kredisë së parë erdhi pas një procesi studimi e reflektimi. Janë shoqëruar në atë periudhë ekspertë dhe specialistë të Bankës Botërore, të cilët gjykonin për format e ndërhyrjes. Kanë kaluar 30 vjet dhe si në shiritin e një filmi të vjetër bardhë e zi vijnë ndër-

mend, përpjekjet e vështirësitë, por sidomos njerëzit, të cilët janë bërë sinonimi i kredisë rurale në Shqipëri.

Kreditë e para do të shërbenin për të blerë dy-tre krerë bagëti, për të mbjellë një kopësht me pemë apo për të blerë tre koshere bletë. Të gjitha këto do të shërbenin për të ushqyer më mirë fëmijët dhe për të menduar për më tej.

Fundi i viteve '90 dhe fillimi i viteve 2000, shënon ngritjen e shumë Shoqërive Kursim Kredi, kryesisht në zonat intensive bujqësore, të cilat dhanë edhe shembullin më të madh të ringritjes së fermave, tashmë private dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme bujqësore

Me 25 Janar 2002, 60 Shoqëritë e Kursim Kreditit që funksiononin, krijuan Unionin SHKK, si bashkim vullnetar i tyre.

Themelimi shënoi një hop tjetër të madh cilësor dhe hapi një prespektivë të re për kreditimin rural në përgjithësi. Filozofia e tij cilësohet dhe me katër parimet themelore të konsoliduara ndër vite siç janë besimi, vullnetarizmi, transparenca dhe solidariteti.

Suksesi tregon më së miri me fakte konkrete dhe rolin promotor në zhvillimin bujqësor e rural në të gjithë zonën e ndërhyrjes, në të 16 rrethet e vendit.

Pas krijimit të Unionit, anëtarët mblidhen çdo vit në Asamblenë e Përgjithshme për të bërë bilancin e vitit. Në gjurmët e lëna në këto 30 vjet kredi rurale dhe 20 vjet Union SHKK, përveç atyre dhjetëra ekspertëve shqiptarë, kanë kontribuar ndjeshëm edhe ekspertët më të njohur evropianë të mikrofinancës.

Unioni Shqiptar Kursim Kredi u transformua në në një SHKK të vetme FED invest, e cila u themelua me 4 dhjetor 2015 nga bashkimi me përthithje i 70 SHKK-ve në një të vetme. Në 2 mars të 2016, Banka e Shqipërisë licencoi SHKK e re FED Invest. Sot kooperativa financiare, lider në Shqipëri me 2500 fshatra, me mbi 81 mijë anëtarë, me një staf të specializuar ekspertësh të mikrofinancës që operon në 62 degë në gjithë territorin e vendit, ka një paketë të larmishme shërbimesh e produktesh financiare dhe jo-financiare në plotësimin e nevojave të anëtarëve.

Në Labinot-Mal, 40 gra arrijnë të kultivojnë për herë të parë produkte dimërore

Në zonën malore të Labinot-Malit në Elbasan, 40 gra kanë arritur të kultivojnë për herë të parë një gamë mbresëlënëse të produkteve dimërore.

UN Women dhe MBZHR, i ka mbështetur me trajnime dhe pajisje të reja përmes programit të përbashkët të OKB-së "BE për Barazinë Gjinore në Shqipëri", financuar nga BE.

Labinoti-Mal është një zonë e thellë malore. Këtu dimri është i gjatë, terreni është i thyer dhe fermerët e zonës punojnë në ngastra të vogla toke.

Për shkak të kushteve klimaterike dhe gjeografike, kjo zonë favorizon prodhimin bujqësor vetëm gjatë verës.

Enver Isufi, ekspert i bujqësisë dhe bashkëpunëtor në këtë projekt, tha se, "për të mbështetur ekonominë rurale në këtë zonë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me programin e OKB-së, ndërmorën një studim paraprak në drejtim të klimës, traditës dhe eksperiencës në bujqësi".

"Së dyti, parashtruam nevojat që ka kjo zonë ", u shpreh ai.

Lirie Banushi, banore në Labinot-Mal, tregoi se kryesisht në këtë zonë më përpara mbillej vetëm patatja dhe domatja e vonë. "Por profesor Isufi na tregoi se si ne të kultivonim edhe produkte të tjera bujqësore, si brokoli, lakra, lulelakra, që nuk i mbillnim më përpara."

Isufi vuri në dukje se të gjithë interesohen për ushqim më të mirë.

"Këtu në këtë zonë të thellë duke shtuar prodhimin e disa kulturave është shtuar edhe gama e vetë kuzhinës. Me njohuri dhe pajisje të mekanizuara, gratë këtu kanë shtuar mbjelljet bujqësore. Gjithashtu përmes investimeve në mikroserra, ato u ndihmuan që të largojnë rrezikun e ngricave ekstreme të dimrit dhe të vijojnë me prodhimin e kulturave bujqësore", tha ai.

Ndërsa Dallëndyshe Drazhi, një fermere tjetër në këtë zonë, tregoi se, "falë kësaj mbështetje, është krijuar grupi i grave që merren me prodhimin e perimeve dhe jemi organizuar t'i shesim në treg po bashkërisht".

"Ne do të vazhdojmë me këtë model biznesi nga eksperienca dhe mbështetja që përfituam nga projekti, pasi po shtojmë të ardhurat për ekonominë tonë dhe po shohim leverdi", tha ajo.

Ukraina do të padisë Poloninë, Hungarinë dhe Sllovakinë për ndalimin e importit të ushqimeve

Ukraina planifikon të padisë Poloninë, Hungarinë dhe Sllovakinë për ndalimin e produkteve bujqësore ukrainase, citoi Politico të ketë thënë përfaqësuesi ukrainas i tregtisë Taras Kachka në një intervistë të botuar të hënën.

Kufizimet e vendosura nga Bashkimi Europian në maj lejuan Poloninë, Bullgarinë, Hungarinë, Rumaninë dhe Sllovakinë të ndalonin shitjet e brendshme të grurit, misrit, farave të rapit dhe luledielli ukrainas, duke lejuar tranzitimin e ngarkesave të tilla për eksport diku tjetër.

Polonia, Sllovakia dhe Hungaria njoftuan kufizimet e tyre në importet e grurit ukrainas të premten pasi Komisioni Europian ekzekutiv vendosi të mos zgjasë ndalimin e tij për importet në pesë fqinjët e Ukrainës në BE.

Varshava, Bratislava dhe Budapesti thonë se po veprojnë në interes të ekonomive të tyre dhe se lëvizjet e tyre synojnë të mbrojnë fermerët e tyre nga një tepricë e produkteve.

"Është e rëndësishme të provohet se këto veprime



janë ligjërisht të gabuara. Dhe kjo është arsyeja pse ne do të fillojmë procedurat ligjore nesër," citoi Politico të thoshte Kachka.

Kachka i tha Politico-s se Ukraina mund të vendosë gjithashtu masa reciproke ndaj Polonisë nëse Varshava nuk heq dorë nga masat e saj shtesë.

"Ne do të detyroheshim të hakmerremi për produktet shtesë dhe do të ndalonim importin e frutave dhe perimeve nga Polonia," citoi Politico të thoshte ai.

Kievi kishte thënë tashmë se mund të kërkonte arbitrazh ndërkombëtar mbi kufizimet.

BE lejoi që ndalimi i saj të skadonte të premten pasi Ukraina tha se do të merrte masa për të forcuar kontrollin e eksporteve në vendet fqinje.

Kachka tha se Kievi ishte gati të "marrë përgjegjësinë për të siguruar që eksporti nga Ukraina nuk po krijon ndonjë cunami në vendet fqinje" dhe do të impononte një sistem licencash eksporti "në kohë reale" për drithërat.


KASH
KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR
SHOQATAT ANËTARE
AVALB
FEDINVEST
BKFSH
EKR
IBMA
HABA
AOA
UPM
LEAA
ADAMA
ABA
SHGF
ALBAFLOR
SHKPVF
RKUK
SVP
MSHKM
BIOADRIA
PPAM
SHT
UOTSH
KEA
BIOPLANT
ADAD
PSN
KËSHILLAT RAJONALE
TIRANA
DURRESI
FIERI
ELBASANI
SHKODRA
DIBRA
LEZHA
GJIROKASTRA
KORÇA
BERATI
VLORA
KUKESI

KASH
Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
www.kashalbania.org
Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

KREDI E SHPEJTË MIKRO
PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË

FED invest

GJITHMONË FINANCË SOCIALE

AGROTURIZËM

Eksperti Guçe: Fluksi turistik, impakt pozitiv te sipërmarrjet e vogla

Ardhja e turistëve nga vende të ndryshme dhe shtrirja e turizmit në zona të ndryshme të Shqipërisë ka bërë që të ndjehet impakti i përfitimeve deri tek bizneset e vogla familjare.

Në një intervistë për Radio Ejani, Ekspert i Zhvillimit te SME-ve Daniel Guçe thotë se janë shumë nënsektorë që kanë lulëzuar.

"Patjetër që ka një impakt të madh tek sipërmarrjet përfshirë ato që quhen kategori mikro, që ne i kategorizojmë si sipërmarrje familjare apo të vetëpunësuar, por edhe tek sipërmarrjet e vogla. Lidhur me ato sipërmarrje që përfitojnë më shumë nga turizmi në Shqipëri, unë do t'i përfshija të tre nënsektorët, por ne synojmë të kemi turizëm gjithëvjetor dhe ai që ofron më mirë shërbimin apo për thithjen e turizmit të huaj është turizmi tematik, që përfshin një sërë formash specifike si agroturizmi, turizmi i eventeve, biznesit, turizmi kulturor ku është trashëgimia kulturore. Ndërkohë në trashëgiminë kulturore përfshihen që nga arkeologjia, historia apo edhe tobjektet e kultit që janë unike në Shqipëri. Por nuk duhet lënë pa përmendur turizmi i gastronomisë apo ai shëndetësor siç janë ato të ujërave termale. Edhe pse nuk është qëllimi kryesor i vizitës turistike, arkeologjia apo trashëgimia kulturore që Shqipëria i ka si pika të forta si dhe produkte unike, Shqipëria ngelet vend konkurrues në këtë drejtim."- tha Guçe.

Është punuar për të patur turizëm gjithëvjetor dhe kjo e ka rritur gamën e bizneseve përfituese.

"Prandaj e veçoj që turizmi tematik, ndryshe nga turizmi natyror apo turizmi bregdetar, i ofron Shqipërisë mundësinë për të patur turizmin gjatë gjithë vitit. Për sa i përket bizneseve, përveç strukturave akomoduese apo restoranteve që janë përfituesit të drejtpërdrejtë në të tre nënsektorët e turizmit, një fluks të madh në rritje kanë patur edhe sipërmarrjet e kantinave të verës, por edhe fermave me karakter bujqësor apo blegtoral që janë në zonën e Kurveleshit, Përmetit, Ersekës apo dhe Korabit. Këtu përmendim dhe të punësuarit në guidat turistike që zhvillohen në hiking."

Jehona në mediat ndërkombëtare ka bërë që te ndjehet një prezencë e lartë e turistëve të huaj, që kalojnë pushimet në Shqipëri, edhe pse shifrat ende nuk janë të plota sepse sezoni vijon.

"Unë do të thoja se turizmi ngelet në sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik dhe nga të dhënat vit pas viti dëshmohet një ngritje e turizmit si një ndër sektorët që sjell më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit, në sipërmarrje apo ato që janë sipërmarrje familjare me kontribut direkt në produktin e brendshëm bruto me rreth 8.5%. Sipërmarrjet në fushën e turizmit janë përmirësuar në të tre nënsektorët: bregdetar, natyror dhe tematik. Për sa i përket shifrave jemi akoma në mes të sezonit dhe ky ka qene një vit që ka shënuar shifra rekord të turizmit të huaj në Shqipëri. Europa është burimi kryesor i turistëve që vijnë për të vizituar Shqipërinë, duke zënë mbi 90% të totalit të turizmit të huaj. Megjithatë së fundmi kemi turistë të cilët vijnë nga SHBA,, apo dhe Azia dhe veçanërisht nga Kina që kanë shënuar një interes domethënës në rritje."

Teksa interesi është në rritje

për të vizituar bukuritë natyrore shqiptare, kjo duhet parë si një mundësi e mirë për të rinjtë që të mendojnë hapje të bizneseve të reja pnë këto fusha potenciale.

"Shqipëria është vendi i mundësive, duke parë që ky vit ka ecur mirë nga fluksi i turistëve që kemi parë deri tani dhe presim fundin e vitit për të parë jo vetëm turizmin bregdetar, por çfarë ka ndodhur gjatë gjithë vitit në Shqipëri. Duke parë një interes në rritje që është marketuar mirë dhe në revistat prestigjioze ndërkombëtare, Shqipëria do të jetë një vend që rritet nga vitit në vit numri i vizitorëve. Të tre nënsektorët qoftë ai natyror, në turizëm apo tematik si dhe bregdetar kanë mundësi pafund për të rinjtë. Kjo jo vetëm në sipërmarrjet klasike siç janë strukturat akomoduese apo restorantet, guidat dhe operatorët turistikë, ku ka një ekosistem shumë të madh apo rezerva të mëdha për të krijuar sipërmarrje për të tërhequr turistët e huaj në Shqipëri."

Eksperti i zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme Daniel Guçe ka edhe një mesazh për të rinjtë që ndodhen në emigrim.

"Është një mënyrë e mirë e vetëpunësimit në turizëm, por kemi shumë histori suksesi që e kanë nisur nga një turizëm familjar dhe sot kanë një xhiro që janë nga një sipërmarrje që ka qenë modeste, por kanë kaluar në nivelin e mesëm për sa i përket kapacitetit që kanë arritur për të tërhequr turistë të huaj. Prandaj ky vit me rekordin e shifrave të turistëve në Shqipëri është një mesazh për të rinjtë që jetojnë apo që kanë zgjedhur të emigrojnë për t'u rikthyer dhe për të investuar në vendin e tyre."- shprehet eksperti Guçe

Reportazh - Vila "ANASTASIA" në Krane, prapatoka turistike e Sarandës

Nga Shkëlqim Hajno

Kur flitet për buum të zhvillimeve turistike në rajonin e Sarandës dhe Ksamilit, shumëkush nuk e di se edhe prapatoka e Sarandës ka zhvillimet e saj me turistët e huaj.

Ende në publikun e gjerë nuk është i njohur mirë fakti që fshati Shelegar (bashkia Sarandë) ka vite që akomodon turistë francezë dhe italianë, falë intuitës së një të riu nga ky fshat. Fakti tjetër është që në fshatin Krane, (bashkia Finiq), kuli.

Në Krane, një fshat i bekuar nga dora e zotit dhe e banorëve, në vilën "ANASTASIA" gjatë këtij sezoni veror mund të takosh turistë nga anë duket se është krejt i panjohur për sarandiotët por sakaq, edhe për vetë banorët e fshatrave të bashkisë Finiq (e përbërë kryesisht nga pakicat etnike greke).

Pyetjes se si e gjetën "ek-

-Gjetën qetësinë dhe zërat e zogjve që pas plazhit, zhurmave të mbrëmjes në qytet dhe stresit të parkimeve, për ta ishte sikur gjetën oazin. Gjetën një pishinë dhe relaks.

Hidhet Anastasia bashkëshortja e Spiros:

- Gjetën edhe ushqimin bio kryesisht me produkte të fshatit...

Është buzëmbrëmje në fushë të Vurgut . Bulkthet e natës dëgjohen pranë. Në oborrin e madh të vilës "Anastasia" po mbërrijnë një nga një me makinat që i parkojnë ngadalë, turistët nga Italia dhe Hollanda.

Një djalosh i ri me mjekër, Maks Lisman Utrecht -nga Hollanda hyn nga porta e oborrit me një qen të zi që e ka nxjerrë shëtitje në lëndinat e Kranesë. Ai na përshëndet anglisht pastaj, me të vetmen fjalë shqip kur ne përkëdhelim qenushin e tij të zi, thotë: "Faleminderit!"

Pastaj në mënyrë pak të zhurmshme dalin një nga një nga dhomat e Vilës grupi i italianëve.

Të sigurt që shqiptarët e dinë pak a shumë gjuhën e tyre, na përshendesin dhe prezantohemi.

Mësojmë se janë tre miq me familjet e tyre. David e Bedini Piombino dhe Susanna.

Davide na prezanton vajzën e cila duket se është kënaqur nga mjedisi i paqtë që e rrethon:

-Vajza ime, Giorgia! 14 vjeç.

-Giorgia Meloni..-hidhet dikush nga ne vizitorët e mbrëmjes.

Italiani që e di për pushimet e kryeministres së tij në Vlorë, thotë me humor:

-Si, si! -dhe e puth vajzën në kokë

-Kam një ftesë për të gjithë ju-na drejtohet italiani.

-.Ne largohemi nesër të kënaqur për në Itali dhe sot, do të respektojmë traditë e krijuar te Vila "ANASTASIA". Sot, ne italianët do të bëjmë darkën e përcjelljes dhe ju, jeni të ftuar!

Shqiptaërt kanë një sens të habitshëm imitimi dhe gare. Ndoshta kjo është genetike.

Pak ditë më parë ishim në Labovën e Kryqit te Vila "Maria", dhjetë çapa nga Kisha e famshme me Kryqin e artë si në legjendë. Frekuentimi po ndodh nga shumë turistë të huaj më tepër, po edhe vendas, tek-tuk. Pamë përreth dhe konstatuam se në disa objekte gjer atëhere të braktisura, po punohej me vrull për t'i shndërruar në bujtina.

-Si jeni me xhelozinë në Krane?-pyesim Spiron.

-Do nisin punën si ju edhe të tjerë?

-Prite kur t'ia bëjë "bam" me të parët pas nesh-rrëfen Çakuli i Kranesë në Vilën "ANASTASIA" në bashkinë minoritare të Finiqit, që nuk ka dalje në det por ndodhet vetëmk pak kilometra nga magjia e blusë së thellë të detit Jon.

është krejtësisht e panjohur në qytetin bregdetar jonian dukuria e frekuentimit nga turistë të huaj gjatë kësaj vere.

Nuk janë të vetmit në këtë bashki. Pak vite më parë disa turistë francezë zbuluan Leshnicën e Sipërme falë pasionit të mësuesi vizionar të gjuhës frenge që quhet Thoma Ni-

të ndryshme të globit si: italianë, polakë, çekë, madje edhe kinezë etj,.

Akomodimi i turistëve të huaj në një fshat si Kranea, rreth 1 km nga kryqëzimi i Urës së Kranese buzë lumit Bistrica, ku akset rrugore këmbejnë vektorët: për Sarandë, Finiq e Tiranë, Qafë Botë e Kakavije;

sploratorët" e parë Vilën "ANASTASIA" buzë rrugës nacionale Sarandë-Krane-Qafë Botë-Igumenicë (Greqi), administratori i Vilës, Spiro Çakuli të tregon:

- Shumë thjesht. Nga bukingu.

-Po ç'gjetën këtu kur mbërritën të parët?

PROJEKTE LOKALE

Investimet në Roskovec, Kryetarja e Bashkise Bufi: Për herë të parë ndërtohen banesa me kosto të ulët

Investimet në infrastrukturë, arsim dhe në banesa sociale në Roskovec, pritet të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së banorëve.

Në një intervistë për ATSH-së, kryetarja e bashkisë Roskovec, Majlinda Bufi ndalet te disa prej këtyre investimeve, të cilat janë në proces dhe impaktojnë një pjesë të gjerë të komunitetit.

Bufi veçoi investimin për herë të parë në territorin e bashkisë Roskovec për ndërtimin e banesave me kosot të ulët.

"Po ndërtohet një objekt 6-katësh banesash me kosto të ulët. Ky investim po realizohet me fondet e Entit Kombëtar të Banesave në vlerën 87,7 milionë lekë. Punimet për këtë objekt kanë filluar në 6 qershor 2023 dhe pritet të përfundojnë më 24 nëntor 2024. Pas përfundimit të punimeve, familjet e reja do kenë mundësi të akomodohen në banesa me kosto të ulët", theksoi ajo.

Një tjetër investim i rëndësishëm, sipas Bufit, po kryhet për banorët e zonës naftëmbajtëse të Marinzës.

Rikualifikimi urban i këtij fshati po realizohet nga fondet e buxhetit të bashkisë në vlerën 11,9 milionë lekë dhe pritet të përfundojë brenda muajit gusht.

"Projekti përfshin ndërtimin e trotuareve, sistemit të ndriçimit dhe lulishes përgjatë kësaj rruge. Bashkia Roskovec ka bashkëpunuar dhe me donatorë, një prej të cilëve është kompania e Bankers Petrolum, e cila nëpërmjet një financimi prej 8,3 milionë lekësh ka bërë të mundur përmirësimin e kanaleve kulluese të kësaj zone", theksoi Bufi.

Duke u ndalur te investimet në arsim, Bufi solli në vëmendje projektin për rikonstruksionin e plotë të shkollës "5 Dëshmorët" në Suk 1, njësia Strum.

"Në këtë shkollë mësojnë rreth 280 nxënës të ciklit të ulët. Si një ndërtim i para viteve '80 rikonstruksioni total i kësaj shkolle ishte një domosdoshmëri dhe një detyrim për komunitetin e kësaj zone. Një projekt me bashkëfinancim midis buxhetit të shtetit dhe buxhetit të bashkisë, vlera e investimit është 80, 7 milionë lekë dhe pritet të mbarojë në fund të gushtit. Projekti përfshin ndërtimin e kopshtit, terreneve sportive të hapura dhe të mbyllura, sistemin e ngrohjes qëndrore, sistemin e ndriçimit etj", shtoi ajo.

Kryebashkiakja theksoi po ashtu se ndërhyrje emergjente po realizohen edhe në fshatin Ngjeqar, Njësia Adminstrative Kurjan, ku po rikonstruktohet shkolla e mesme "Didin Bishani".

"Një nga investimet më të rëndësishme në sistemin arsimor i cili po realizohet aktualisht, është ai në shkollën e mesme "Didin Bishani" në Kurjan, pjesë e projektit 'Rivitalizimi i shkollës Qendër Komunitare", për një akses më të mirë në zhvillimin socio-ekonomik të të rinjve dhe grupeve të disavantazhuara", tha ajo.

Bufi theksoi se ky projekt po realizohet me fonde të Komisionit Europian në vleren 19,3 milionë lekë dhe po ashtu pritet të përfundojë në muajin gusht.

"Shumë shpejt ky investim do t'i krijojë mundësinë të rinjve të Kurjanit për të ndjekur orët mësimore me ambiente bashkëkohore dhe ambiente të formimit profesional për të qënë pjesë e tregut të punës, si një mundesi integrimi dhe socializimi, pavarësisht kushteve në të cilat ndodhen", theksoi ajo.

Në infrastrukturë, Bufi u ndal edhe te ndërhyrjet emergjente që po kryhen në fshatin Ngjeqar, njësia administrative Kurjan, me mbështjen e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

"Ndërhyrjet përfshijnë riparimin e shkarjeve në dy lagje, punimet në rrugën Ngjeqar-Kurtaj si dhe punimet për përroin e Allambrezit. Edhe ky investim pritet të përfundojë brenda muajit gusht, duke garantuar kështu mbrojtjen dhe sigurinë e jetës së banorëve në rrethana të ndryshme natyrore", shtoi ajo.



Maqedoni e Veriut, shqetësime nga ulja e nivelit të Liqenit të Prespës

Banorët përreth Liqenit të Prespës në Maqedoninë e Veriut i druhen katastrofës pasi niveli i ujit të liqenit ka rënë dukshëm. Në një raport të vitit 2022, NASA thotë se pamjet satelitore tregojnë se liqeni kishte humbur 7% të sipërfaqes dhe gjysmën e vëllimit të tij midis viteve 1984 dhe 2020. Mungesa e reshjeve, përdorimi i tepërt i ujit për ujitje janë arsyet kryesore të rënies së nivelit të ujit të liqenit që ndahet mes Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Greqisë.

Në një pjesë të bregut të liqenit të Prespës i cili ndahet mes Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, një platformë prej druri e rrethuar më parë nga ujërat e liqenit në fshatin maqedonas Stenje tani qëndron mbi tokë të thatë.

Aleksandar Ilievski, i rritur në fshat, e sheh me trishtim këtë ndryshim. Hera e fundit kur ai dhe miqtë e tij u hodhën nga aty për në liqen ishte pesë vjet më parë.

"Unë jam rritur në këtë fshat dhe të gjithë vinim të hidheshim nga kjo platformë në ujë. Në vitin 2018 e bënim një gjë të tillë gjithë kohës, por tani nuk ka më ujë", thotë zoti Ilievski.

Nivelet e ujit në Liqenin e Prespës, një nga liqenet më të vjetër të Evropës ku gjenden më shumë se 2000 lloje peshqish, shpendësh, gjitarësh dhe bimësh, tani janë mbi 8 metra më të ulëta se në fund të viteve 1970.

Në një raport të vitit 2022, NASA tha se pamjet satelitore tregojnë se liqeni kishte humbur 7% të sipërfaqes dhe gjysmën e vëllimit të tij midis viteve 1984 dhe 2020.

Peshkatari Vanço Vasilevski thotë se varka e tij ngec shpesh kur lundron në liqen.

"Në dy, tre muajt e fundit uji ka rënë 36 centimetra dhe në dy, tre ditët e fundit niveli i ujit besoj ka rënë edhe dytre centimetra të tjera. Niveli i ujit do të bjerë edhe më shumë. Nuk ka shi, nuk ka dimër, pa borë, pa lumenj. Vetëm një lumë derdhet në liqen, nuk ka furnizim tjetër me ujë. Kjo është një fatkeqësi natyrore", thotë zoti Vasilevski.

Më shumë se dy të tretat e liqenit 5 milionë vjeçar i përkasin Maqedonisë së Veriut dhe pjesa tjetër Greqisë dhe Shqipërisë.

Ambientalistët thonë se mungesa e shiut, avullimi dhe përdorimi i tepërt i ujit për ujitje nga të tre vendet janë arsyet kryesore të rënies së nivelit të ujit.

Dragan Arsovski, biolog nga organizata joqeveritare Shoqëria Gjeologjike Maqedonase, me qendër në Shkup, thotë se niveli i liqenit është ngritur dhe ka rënë gjatë shekujve dhe natyra mbijetoi, por njerëzit që jetojnë përreth liqenit nuk po përshtaten me situatën e re.

"Shumë kafshë kanë mbijetuar. Ajo që është unike tani është se ne po kontribuojmë

në këtë efekt të ndryshimeve mjedisore dhe tani niveli i ujit po ulet. Por ne, njerëzit që jetojmë atje, nuk dimë se si të përballemi me këtë sepse ne jemi mësuar me liqenin siç ishte, veçanërisht në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë kur niveli ishte shumë më i lartë, ndoshta deri në tetë metra më i lartë se sa e shohim tani", thotë zoti Arsovski.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim ka paralajmëruar se disa lloje kafshësh të egra në liqen janë në rrezik të zhdukjes për shkak të shkatërrimit të habitatit të tyre nëpërmjet praktikave të dëmshme bujqësore, erozionit, mbetjeve të patrajtuara dhe ujërave të zeza.

Fermeri i një pemishteje, Mende Pandevski thotë se pesticidet po rrjedhin në liqen përmes puseve nëntokësorë që shfrytëzohen për të ujitur tokat e mbjellura afër liqenit dhe të cilët janë më të dëmshëm se ato në të kaluarën.

"Pesticidet hyjnë në ujërat nëntokësorë, në liqen, ato shkojnë kudo dhe janë shumë të rrezikshme për Prespën. Pesticidet moderne nuk janë si ato që kemi pasur. Ne nuk e dimë se çfarë po blejmë nga prodhuesit. Kjo është një katastrofë, asgjë nuk po shkon mirë", thotë zoti Pendevski.

Pushteti lokal i komunës së Resnjës, territori i së cilës përfshin tërë bregun e Maqedonisë Veriore të liqenit, ka marrë mostra për të kontrolluar praninë e pesticideve dhe kimikateve.

"Në pika të caktuara në liqenin e Prespës kemi një përkeqësim të gjendjes në cilësi dhe këtë ne e analizojmë së bashku me institucionin hidrobiologjik nga Ohri", thotë Ajman Al Alla nga komuna e Resnjës.

Kjo analizë tregon se cilësia e ujit po përkeqësohet në disa drejtime kyçe, tha kreu i departamentit komunal të mjedisit në Resnje.

TEMË E DITËS

Procesi i Berlinit më 26 shtator në Tiranë Forumi i Ministrave të Ekonomisë

Në kuadër të procesit të Berlinit, që do të zhvillohet në Shqipëri më 16 tetor 2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë organizon në Tiranë, në datë 26 shtator, Forumin e Ministrave të Ekonomisë me titull, "Tregu i përbashkët rajonal – një hap drejt Tregut Unik të BE"

Ministria e Financave dhe Ekonomisë njofton se forumi do të mbledhë së bashku ministrat e Ekonomisë të Procesit të Berlinit, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe partnerë të tjerë të Procesit të Berlinit, me fokus avancimin e tregut të përbashkët rajonal, për të nxitur zhvillimin e rritjes ekonomike të rajonit dhe për ta sjellë atë më afër BE-së.

Ky forum do të reflektojë mbi arritjet, prioritetet dhe sfidat kryesore në zbatimin e këtij plani dhe avancimin e agjendës së integrimit rajonal nëpërmjet mbështetjes në kuadër të Procesit të Berlinit, si një instrument shumë i rëndësishëm për përshpejtimin e konvergjencës ekonomike të rajonit me Bashkimin Europian. Në këtë takim, do të diskutohet mbi lehtësimin e tregtisë dhe reduktimin e barrierave, integrimin e tregjeve, rritjen e bashkëpunimit rajonal, integrimin e sistemeve të pagesave të rajonit dhe përgatitjen ekonomike të Ballkanit Perëndimor për një integrim eventual në Eurozonë.

Gjithashtu, diskutimet do të përqendrohen edhe në integrimin e përshpejtuar dhe qasjen e hershme në Tregun Unik të BE-së. Në këtë kuadër, do të diskutohet edhe lidhur me sfidat kryesore për përmirësimin e konvergjencës ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE, në mënyrë që të



përcaktohet orientimi politik dhe hapat konkretë, në kuadër të Procesit të Berlinit, sa i takon mbështetjes që duhet të marrin vendet e rajonit.

Gjithashtu, diskutimet do të përqendrohen edhe në integrimin e përshpejtuar dhe qasjen e hershme në Tregun Unik të BE-së. Në këtë kuadër, do të diskutohet edhe lidhur me sfidat kryesore për përmirësimin e konvergjencës ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE, në mënyrë që të përcaktohet orientimi politik dhe hapat konkretë, në kuadër të Procesit të Berlinit, sa i takon mbështetjes për qasjen e hershme në Tregun Unik të BE-së nga ekonomitë e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Së bashku me Forumin e Ministrave do të zhvillohet Forumi i Biznesit, me titull "Hyrja në Tregun Unik si një potencial për rritje për Ballkanin Perëndimor". Ky forum synon të paraqesë arritjet kryesore dhe hapat drejt integrimit në BE, si dhe të theksojë nevojat dhe rekomandimet nga komuniteti i biznesit të Ballkanit Perëndimor për të shfrytëzuar plotësisht potencialet e rritjes së rajonit. Forumi bashkëorganizohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Forumi i Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor 6 (WB6 CIF), së bashku me Unionin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë.

Procesi i Berlinit është një iniciativë që synon rritjen e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe dhënien e ndihmës për integrimin e vendeve të këtij rajoni në Bashkimin Evropian. Ai u prezantua në 28 gusht 2014 nga kancelarja gjermane Angela Merkel.

Procesi i Berlinit po zhvillohet me mbështetjen e Komisionit Evropian, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe shteteve anëtare të përfshira në Proces – Gjermani, Francë, Austri, Kroaci, Itali, Slloveni dhe Mbretëria e Bashkuar, së bashku me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Këshillimi Smart - Hidet

Përfitueshmëria e kultivimit të hides (kimca)

Hidja është një frut me origjinë nga Kina e largët me mbi 4,000 vjet që kultivohet në

të gjithë botën me më shumë se 400 varietete. Në Shqipëri, në varësi të zonave ku kultivohet njihet me emrin ide (Shqipëria e mesme), xinxifille (në zonat e jugut) dhe kimca (në zonat e veriut). Hiden e gjen të kultivuar në Tiranë, Durrës, Krujë, Lezhë, Shkodër, Lushnjë, Fier dhe Berat.

Hidet përmbajnë magnez, kalcium, fosfor dhe hekur. Ato përmbajnë 20 herë më shumë vitaminë C se çdo agrume tjetër, që forcon sistemin imunitar dhe lufton infeksionet duke u përdorur si ilaç mjekësor në formën e çajit (përzier edhe me disa bimë medicinale) për mijëra vjet në shumë kultura në botë. Përfitueshmëria e kultivimit të hides lidhet edhe me përdorimin e frutit për konsumim, bërthamës së frutit dhe gjethes për mjekësi, si dhe trungut të saj si dru dekorativ.

Kultivimi i hides dhe shërbimet agro-teknike

Hidja është një pemë që përballon temperaturat ekstreme dhe lulëzon në kushte mjaft të thata. Cilësia e frutave është më e mira në kushte të nxehta, me diell dhe thatësirë, por duhet të ketë një sezon me shi për të mbështetur rritjen dhe lulëzimin e zgjatur, duke siguruar lagështi të mjaftueshme të tokës për të çuar frutin deri në maturim. Është e njohur për aftësinë e saj për t'i bërë ballë kushteve të pafavorshme, të tilla si kripësia, thatësira dhe ujin e tepërt. Në vendet aziatike pemët japin 80 deri në 200 kg fruta të freskëta në vit, kur pemët janë në moshën e tyre të prodhimit 10-20 vjeçare. Në këto vende për ngritjen e pemishteve distanca e rekomanduar është 7 x 7 m ose 8 x 8 m.

Në Shqipëri format intensive të kultivimit të hides kanë rezultuar me sukses, në distanca 3 x 4 m ose 4 x 4 m, pra 600-800 rrënjë/ha. Hidja nuk kërkon krasitje në 7-8 vitet e para, dhe arrin të hyj në prodhim në vitin e 4-t duke siguruar një prodhim me rreth 10 kg/pemë. Në vitin e 10-të arrin të hyjë plotësisht në prodhim duke siguruar një prodhim rreth 20-25 kg/pemë. Hidja nuk ka kërkesa për spërkatje apo plehrim (nuk pranon plehra kimike) për arsye të sistemit rrënjor delikat, por paraqet ndikim pozitiv ndaj plehrimit organik. Kërkon një ujitje të rregullt gjatë periudhës së verës, pra gjatë temperaturave të larta. Gjithashtu vlen të përmendet së kultivimi i hides kërkon fuqi punëtore më të madhe në vjelje se kulturat e tjera, nisur nga normativa e vjeljes 50 kg/person/ditë.

"Fermerë, kultivoni produkte të veçanta të kërkuara nga tregu"

Në Shqipëri konsumi i hides është i lartë dhe mos-plotësimi i kërkesës së konsumatorit bën që 60% e kërkesës të plotësohet me hide importi me origjinë nga Greqia dhe Turqia. Ngritja e një pemtore me hide ka një kosto rreth 12,000 euro së bashku me sistemin mbështetës. Nisur nga kalkulimet e kryera nga ekspertët e NOA-s, kthyeshmëria e këtij investimi është jo më shumë se 6 vite nga periudha e mbjelljes. Të ardhurat nga kultivimi i hides shkojnë nga 15,000-20,000 euro/ha/vit.



La Greqinë për Shqipërinë, emigranti: Gjynah ta lësh tokën pa punuar e të shkosh jashtë shtetit!

Lulzim Kurti është një emigrant që vendosi 6 vite më parë të kthehej në atdhe për të investuar paratë e tij në bujqësi.

Ai thotë se ka punuar për 15 vite në Greqi dhe se është gjynah që të lësh tokën pa punuar në Shqipëri dhe të shkosh jashtë shtetit.

"Ia vlen të merresh me bujqësi. Është gjynah ta lësh tokën pa punuar e të shkosh jashtë shtetit. Në Greqi kam punuar 15 vite me 25 euro dita, atje do të paguash qiranë, ujë drita dhe në fund ngel pa asgjë", është shprehur Lulzimi në një intervistë për Top Channel.

"I kam rezistuar tregut pasi mundohem të nxjerr një produkt të pastër. Për të luftuar fluturën e bardhë përdor këto shirita që më ulin numrin e spërkatjeve, ndërs për pjalmimin e domates dikur përdorej hormone për lidhjet e kokrrës, kurse tani përdor vetëm bletë të cilat gjithashtu me shtojnë rendimentin. Dhe bima del fantastike".

Pas suksesit ne sera ish-emigranti, tre vite më parë ai zgjeroi fermën e tij duke mbjellë pemë drufrutore.

Lulzimi thotë se oreksi vjen duke ngrënë, pas perimeve dhe frutave radhën e ka ngritja e një kapanoni shpendësh, ku do të rriten zogj të freskët.

Rama: Rruga Peshkopi-Maqellarë, në mbështetje të bujqësisë e agroturizmit

Në kantierin e rrugës Peshkopi-Maqellarë, vazhdim i rrugës së Arbrit, punimet po ecin me ritme të shpejta.

Lajmi u bë i ditur nga Kryeministri Edi Rama në një postim në rrjetet sociale.

Rama tha se "ky aks i rëndësishëm, vazhdim i rrugës së Arbrit, do të shërbejë jo vetëm për shkurtimin e distancave të lëvizjes së automjeteve, mes fshatrave përreth Dibrës e Tiranës, por edhe për të nxjerrë në pah vlerat e turizmit verior, në mbështetje edhe të bujqësisë e agroturizmit të zonës".

Investimi do të përmirësojë cilësinë dhe standardet e rrugës që është e kategorisë C2, por nga ana tjetër do të shkurtojë në 9 nga 11 km që është aktualisht rruga Maqellarë-Peshkopi.

Me përfundimin e punimeve rruga nga dalja e Tiranës deri në Peshkopi do të përshkohet për 1 orë, ndërsa do të nxisë fluksin e qarkullimit të vizitorëve dhe turistëve në këtë zonë.

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji tetor 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Pamja e qiellit gjatë muajit tetor 2023

Më 8 dhe 9 tetor - Dushi meteor Draconids. Draconids është një shi i vogël meteorësh që prodhon vetëm rreth 10 meteorë në orë. Ai prodhohet nga kokrrat e pluhurit të lëna pas nga kometa 21P Giacobini-Zinner, e cila u zbulua për herë të parë në vitin 1900. Draconids është një dush i pazakontë në atë që shikimi më i mirë është në mbrëmjen e hershme në vend të mëngjesit të hershëm si shumica e dusheve të tjera. Dushi fillon çdo vit nga data 6-10 tetor dhe kulmin e ka këtë vit natën e datës 8 tetor dhe mëngjesin e datës 9 Tetor. Gjysma e dytë e Hënës do të jetë e dukshme në mëngjes herët, por nuk do të ndërhyjë shumë. Shikimi më i mirë do të jetë në mbrëmjen e hershme nga një vend i errët larg dritave të qytetit. Meteorët do të rrezatojnë nga konstelacioni Draco, por mund të shfaqen kudo në qiell.

Më 14 tetor - Hëna e re. Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 19:55 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objekte të zbehta si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë të hënës që të ndërhyjë.

Më 14 tetor - Eklipsi unazor i diellit. Një eklips unazor diellor ndodh kur Hëna është shumë larg nga Toka për të mbuluar plotësisht Diellin. Kjo rezulton në një unazë drite rreth Hënës së errësuar. Kurora e Diellit nuk është e dukshme gjatë një eklipsi unazor. Rruga e eklipsit do të fillojë në Oqeanin Paqësor në brigjet e Kanadasë Jugore dhe do të lëvizë në jugperëndim të Shteteve të Bashkuara dhe Amerikës Qendrore, Kolumbisë dhe Brazilit. Një eklips i pjesshëm do të jetë i dukshëm në pjesën më të madhe të Amerikës Veriore dhe Jugore.

Më 20 dhe 21 tetor - Shiu meteor i Orionideve. Orionids është një shi mesatar që prodhon deri në 20 meteorë në orë në kulmin e tij. Shiu prodhohet nga kokrrat e pluhurit të lëna pas nga kometa Halley, e cila është e njohur dhe vëzhguar që nga kohërat e lashta. Shiu fillon çdo vit nga data 2 tetor deri më 7 nëntor. Kulmin e ka këtë vit në natën e 20 tetorit dhe në mëngjesin e 21 tetorit. Gjysma e parë e hënës mund të bllokojë disa nga meteorët e zbehtë në mbrëmje, por do të perëndojë pak pas mesnate. Kjo do të lërë qiej të errët për atë që mund të jetë një shfaqje e mirë mëngjesi. Shikimi më i mirë do të jetë nga një vend i errët pas mesnate. Meteorët do të rrezatojnë nga konstelacioni Orion, por mund të shfaqen kudo në qiell.

Më 23 tetor - Afërdita në zgjatimin më të madh perëndimor. Planeti Venus do të arrijë zgjatjen më të madhe lindore prej 46.4 gradë nga Dielli. Kjo është koha më e mirë për të parë Venusin pasi ajo do të jetë në pikën e saj më të lartë mbi horizont në qiellin e mëngjesit. Kërkoni planetin e ndritshëm në qiellin lindor para lindjes së diellit.

Më 28 tetor - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës nga Dielli dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 22:24 UTC. Kjo hënë e plotë njihej nga fiset e hershme indigjene të Amerikës si Hëna e Gjuetarëve, sepse në këtë kohë të vitit gjethet do të bien dhe gjahu është e majme dhe e gatshme për gjueti. Kjo hënë është njohur edhe si Hëna e Udhëtimit dhe Hëna e Gjakut.

Më 28 tetor - Eklipsi i pjesshëm i Hënës. Një eklips i pjesshëm hënor ndodh kur Hëna kalon nëpër hijen e pjesshme të Tokës, ose gjysmën e tokës, dhe vetëm një pjesë e saj kalon nëpër hijen më të errët ose ombrën. Gjatë këtij lloji të eklipsit, një pjesë e Hënës do të errësohet ndërsa lëviz nëpër hijen e Tokës. Eklipsi do të jetë i dukshëm në të gjithë Evropën, Azinë dhe Afrikën dhe Australinë perëndimore.

Parashikimi i motit për muajin tetor 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë D	Km/Orë N	Drejtimi D	Drejtimi N			
1	26	16	27-16-24	0	0	9	4	JL	LJL	4	Kryesisht me diell	
2	26	16	26-16-15	0	0	7	6	JL	JJP	4	Kryesisht me re	
3	26	17	26-17-25	0	0	7	6	VL	VVP	1	Kryesisht me re	
4	27	17	29-29-26	0	0	6	6	VL	V	4	Kohë me diell dhe njolla resh	
5	27	18	28-18-26	0	0	7	7	VL	V	4	Kryesisht me diell	
6	27	18	27-18-25	0	0	7	4	VL	JJP	4	Kryesisht me diell	
7	27	17	28-17-26	0	0	7	6	JL	J	4	Kryesisht me diell	
8	27	18	26-15-26	5.5	2	7	11	JL	JJL	2	Kohë me re e diell me disa shira dhe stuhi pasdite	
9	26	18	25-15-25	21.4	8	11	7	JJL	JL	1	Vranësirë me disa shira dhe ndonjë stuhi	
10	24	18	24-17-24	7.6	3	6	7	LVL	VL	1	Disa shira dhe ndonjë stuhi në mëngjes pastaj re	
11	23	17	23-16-22	0	0	11	9	LVL	LVL	3	Kohë me re dhe diell	
12	23	12	23-11-22	0	0	15	11	V	VVL	4	Kryesisht me diell	
13	23	12	23-13-21	0	0	7	4	VVP	PVP	4	Plot me diell	
14	23	13	23-13-21	0	0	7	6	P	V	4	Plot me diell	
15	24	14	25-11-22	0	0	9	17	VVL	VL	4	Kryesisht me diell	
16	25	15	25-13-24	0	0	11	13	VL	VL	4	Plot me diell	
17	25	13	25-9-24	0	0	13	28	VVL	VL	4	Kohë me diell	
18	25	11	24-7-23	0	0	22	20	VL	LVL	3	Pjesërisht me diell	
19	22	11	22-10-20	0	0	11	7	LVL	LJL	3	Diell i bollshëm	
20	22	11	22-10-20	0	0	7	4	PJP	VP	3	Diell i bollshëm	
21	22	15	23-14-21	0	0	6	11	JJL	JL	3	Diell	
22	22	15	22-11-20	0	0	11	19	JJL	JL	3	Diell	
23	22	15	22-11-20	8.5	4.5	30	26	JL	JJL	2	Kryesisht me vranësira me ndonjë shi të rastit pasdite	
24	21	16	21-14-20	5.6	2.5	17	15	J	JJL	1	Kryesisht me re me disa shira dhe stuhi, kryesisht në fillim të ditës	
25	22	16	21-14-21	0	0	17	19	J	J	2	Kryesisht me re	
26	24	14	24-11-22	0	0	13	11	JJP	J	3	Intervale i reve dhe kohë me diell	
27	25	12	24-8-23	2.6	1.5	20	20	JP	PVP	3	Diell dhe disa re me disa shira në pasdite	
28	20	10	19-5-18	0	0	22	20	VVP	V	3	Diell në pjesën më të madhe të kohës	
29	20	10	19-6-18	0	0	24	20	VVL	LVL	3	Kohë me diell	
30	20	10	22-11-20	0	0	6	2	J	JJP	3	Kryesisht me diell	
31	21	10	22-10-21	0	0	4	6	JP	VL	3	Kohë me re dhe diell	

Parashikimi i motit për tetor 2023 në Korçë (Zona e ftohtë)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë D	Km/Orë N	Drejtimi D	Drejtimi N			
1	19	7	22-8-19	0	0	4	2	JJL	JJP	5	Diell	
2	20	7	23-8-19	0	0	4	2	LJL	L	5	Vranësirë në rritje	
3	20	7	21-9-21	0	0	2	2	LVL	VVP	1	Kryesisht me re	
4	22	9	24-10-21	0	0	2	6	VL	PVP	4	Kryesisht me diell	
5	22	9	24-10-21	0	0	4	4	VVL	VL	4	Kryesisht me diell	
6	21	9	24-10-20	0	0	6	4	JL	JJP	4	Kryesisht me diell	
7	21	9	24-10-20	0	0	4	2	J	JP	2	Diell dhe pak re	
8	21	10	21-10-20	1.2	1	4	4	JJL	J	2	Kohë me re dhe diell	
9	21	10	21-9-21	4.8	4	6	4	J	JP	1	Vranësirë; njëshi me pika në mëngjes i pasuar nga një shi i vogël pasdite	
10	20	9	20-8-20	9.3	6	4	4	LJL	LVL	1	Vranësira me reshje	
11	19	9	19-8-19	1.7	2.5	7	7	LVL	LVL	1	Kryesisht me re me ndonjë shi të vogël	
12	17	5	17-5-15	0	0	13	7	V	V	4	Kryesisht me diell	
13	17	5	19-6-16	0	0	7	4	VVP	VVP	4	Plot me diell	
14	17	7	19-7-17	0	0	7	6	PVP	V	4	Kryesisht me diell	
15	19	8	22-6-18	0	0	6	9	VVL	VL	4	Kryesisht me diell	
16	20	8	22-8-19	0	0	7	7	VL	VL	4	Plot me diell	
17	20	6	21-3-19	0	0	9	17	V	VL	4	Diell i shndritshëm	
18	20	3	19-0-18	1	1.5	15	13	LVL	LVL	3	Kryesisht me re me ndonjë shi të vogël	
19	16	3	18-3-15	0	0	9	6	L	LJL	4	Kryesisht me diell	
20	15	4	18-6-15	0	0	4	2	JP	VVP	4	Kohë me diell	
21	15	8	18-8-16	0	0	2	4	P	JL	4	Plot me diell	
22	17	8	18-5-16	0.6	0.5	9	11	JJL	JL	4	Pjesërisht me diell me disa shira në pasdite	
23	15	7	13-4-13	10.6	7	19	15	LJL	JL	2	Periudhë me shira	
24	16	8	17-8-17	4.2	3	9	6	JJP	J	1	Plot me re me disa shira	
25	18	8	19-8-18	0	0	7	7	J	JJP	2	Periudhë me re dhe kohë me diell	
26	18	7	20-8-18	0	0	9	4	PJP	JP	3	Interval i reve dhe kohë me diell	
27	19	6	19-3-18	0	0	13	15	JP	P	3	Pjesërish kohë me diell	
28	15	2	15-(-2)-13	0	0	17	15	VP	VVP	3	Diell pjesën më të madhe të kohës	
29	14	2	12-0-11	0	0	19	13	V	VL	3	Diell	
30	15	3	18-3-16	0	0	4	4	LJL	LJL	3	Kryesisht me diell	
31	16	2	18-2-18	0	0	4	6	JJL	JJP	3	Pjesërisht kohë me diell	

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit tetor 2023

